



# shqipëria Etnike

E shtunë  
31 mars 2018

Viti XVIII  
nr 161

Çmimi  
30 L / 1 euro

E pavarur,  
periodike

www.shqiperia-etnike.com  
shqiperia\_etnike@yahoo.com

English, page 14

Drejtore  
Sokol Pepushaj



Në fund, ju nuk vlerësoheni se sa shumë keni ndërmarrë, por çfarë arrini në fund!

**TRUMP**



**KJO ËSHTË EPOKA E DONALD TRUMP**  
Redaksia  
faqe 6-7



**E DREJTA E PRONËS ËSHTË PRONËSIA MBI LIRINË TONË**  
Jorida Tabaku  
faqe 10



**KRYEMINISTRI I PËRFSHIRËNË GRABITJE**  
E. Alibejaj  
faqe 2

## Vetting-u:

**Edi Rama drejt fundit të pashmangshëm, por ende vazhdon me korrupsionin kryeministor!**



Spartak Ngjela

Reforma në Drejtësi duhet të shpejtohet në ecurinë e saj; dhe politika amerikane duhet të fillojë denoncimin e fakteve realë, ashtu sikundër që bëri për aferën e Bashës me politikën ruse, se sot janë të bashkuar të dy krahët e korrupsionit. Por kanë frikë të dalin hapur. Pikërisht kjo frikë duhet të shfrytëzohet nga politika amerikane.

Shikoheni gjetjen absurde por korruptive të Teatrit Kombëtar. Zotërinj; Teatri Kombëtar si objekt i kulturës së lartë nacionale, është dhe duhet të jetë patjetër vepër e shqiptarëve dhe jo vepër apo prodhim i tregut.



# Triptiku i laryshisë

Nga EDI RAMA

Mund të quhej vetëm Mehmet mbetja zeshkane e një bashkimi midis dy qenieve lëkurëzeshkëta që pas një nate të rrokpushme dashurie u bënë prindërit e tij. Ishin dy krijesa kaq të ngjashme njëra me tjetrën, sa zgjonin krejt admirimin tim. I admiroja, sepse më ngjanin si vëlla e motër dhe një ngjashmëri e tillë ishte për mua kulmi i harmonisë së çiftit. Ai i jati i Mehmetit, me ca sy të mëdhenj si një e verdhë e zezë veze, hundë të përthyer shqiponjë prej stërnipi të një ushtari turk, që ka gjetur netë kënaqësie të ndaluar rrëzë ndonjë kodre koçimaresh në Shqipëri, mustaqe të bollshme që i lëpinte parreshtur buzë të mishta dhe mjekër të mprehtë thikë, ndërsa ajo e ëma, sy ngahera të shqyer habie prej bëmave të djalit të pandreqshëm, ... faqe 8-9

## Shkodër: Terroristë me maska sulmojnë për të vrarë një emigrant

Dje në qytetin verior, ditën për diell, rreth orës 10 e 30 minuta, në mes të qytetit, përballë Katedrales së Shkodrës, tre persona me maska, kanë terrorizuar qytetërit dhe kanë dhunuar fizikisht një emigrant, i cili ishte kthyer nga Amerika

vetëm një ditë para ngjarjes. Është dhunuar barbarisht, sa është përgjakur vëndi, emigranti Vitor Pukri. Deshmitarë në vëndin e ngjarjes, të cilët kanë frikë të identifikoohen për gazetën, deklarojnë se tre personat me maska kishin

qëllim ta vrasin viktimën, por dy persona të rastësishëm, kanë ndaluar makinën e tyre dhe janë konfliktuar fizikisht me dhunuesit për të mbrojtur jeten e emigrantit dhe kanë arritur ta marrin ...

faqe 5



# Edhe Kryeministri Rama i përfshirë në grabitjen e pronave?!

Partia Demokratike përmes deputetit Enkelejd Alibeaj ka akuzuar rëndë kryeministrin Rama si person i përfshirë direkt në grabitjen e pronës së Iri Buës në Dhërmë.

## Deklarata e plotë e Enkelejd Alibeaj:

Dokumentet e lejes zhvillimore dhe të ndërtimit në pronën e grabitur prej Alket Hysenit, në shkelje të vendimit të Gjykatës, provojnë se Edi Rama është në krye të skemës mafioze për grabitjen e tokave në bregdet.

Grabitja e tokës në bregdet me 11 mijë metra katrorë nga deputeti Alket Hyseni, është bërë në bashkëpunim me Kryeministrin e vendit, Edi Rama, i njëjti kryeministër që bërtet për drejtësi dhe përbetohet çdo ditë se po bën shtet.

Partia Demokratike ka në dorë dokumente që provojnë se Edi Rama është pjesë e skemës për grabitjen e tokave në bregdet, në rastin konkret të grabitjes së pronës së familjes Bua në Dhërmë.?



## Le t'i rendisim faktet me radhë.

I emëruar në detyrën e kryetarit të Task Forcës për të evidentuar tjetërsimin e pronave në bregdetin e Jugut nga Vlora në Butrint, Alket Hyseni ka blerë për 230 milionë lekë pronën e tjetërsuar me dokumente të falsifikuar, duke e ditur se prona ishte në proces gjyqësor.

Dokumenti vërteton se në vitin 2015 Gjykata e Vlorës i dha të drejtë familjes së zonjës Iri Bua duke vendosur pezullimin e çdo veprimi mbi pronën, vendim ky që është akoma në fuqi.

## Vendimi i gjykatës

Por pavarësisht këtij vendimi Gjykate, në shtetin mafioz të Edi Ramës transaksionet me pronën në bregdet kanë vazhduar nga falsifikuesi tek Alket Hyseni, pastaj tek ndërtuesi Gon Papuli, që është një nga miqtë e ngushtë të kryeministrit, për të shkuar më pas deri tek vetë Edi Rama.

Partia Demokratike ka dy dokumente që provojnë se Edi Rama është pjesë e skemës mafioze për grabitjen e pronave dhe shpjegojnë përse kryeministri ka heshtur deri tani për deputetin e vet Alket Hyseni. Edi Rama, me firmën e tij, ka vendosur dy herë rresht që, në tokat në bregdet të familjes Bua, në Dhërmë, të ndërtohet resort turistik, duke mos marrë parasysh vendimin e Gjykatës për pezullimin e çdo veprimi me pronën.


Dokumenti i parë tregon se Edi

Rama, si Kryetar i Këshillit Kombëtar të Territorit, ka firmosur lejen për zhvillimin e kompleksit turistik dhe një vit më pas ka firmosur sërish, për dhënien e lejes së ndërtimit në këtë kompleks për mikun e tij ndërtues Gon Papuli dhe për deputetin e tij, Alket Hyseni.

Është e qartë se skema mafioze e grabitjes së tokave në bregdetin ka në krye Edi Ramën dhe për bashkëpunëtor deputetin e tij Alket Hyseni që, në kohën e dhënies së lejeve nga Edi Rama, drejtonte Zyrën Kundër Pastrimit të Parave, prej nga ka mbikëqyrur edhe transaksionet

financiare të bankës së gruas së kryeministrit.

Peshk më të madh se kaq drejtësi nuk ka ku të gjejë dhe është rasti ideal për t'u dhënë shqiptarëve shpresën reale për një drejtësi jopolitike, që punon për qytetarët dhe jo për pushetarët.



# Vettingu/ Sulejmani, vjehrrri i Edi Ramës “fiton” pronat me gjykatës të korrumpuar duke bërë dy persona të vdekur si të gjallë në vendimin e datës 28 dhjetor 2017. Ja dokumentat!

Gazetari Basir Çollaku ka denoncuar një vendim të Gjykatës së Apelit të Tiranës, i cili favorizon vjehrrin e kryeministrit Rama, Sulejman Basha.

Në vendimin e marrë në datën 28 dhjetor të vitit 2017, Apeli i cilëson dy persona të vdekur prej kohësh si të gjallë, duke marrë një vendim në favor të paditësve.

Gjatë procesit, Gjykata i ka konsideruar si palë mungesë në gjyqin për pronat Fadil dhe Xhemile Toptanit, të cilët kanë vdekur respektivisht në 03.10.2010 dhe 09.11.2014. Duke qenë të vdekur, sipas ligjit duhet që akti i trashëgimisë të ribëhej dhe në gjyq të merrnin pjesë trashëgimtarët.





Vjehrrri i Ramës, Sulejman Basha, vëllai i tij Hasan Basha, Muharrem Basha dhe Hyrie Bali, kanë paditur disa familje Toptani në Agjencinë e Trajtimit të Pronave dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive, duke kërkuar rrëzimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, që kishte rrëzuar pretendimet e tyre.

Edhe pse në dosjen gjyqësore ekzistojnë certifikatat e vdekjes të Fadil dhe Xhemile Toptanit dhe vendimet përkatëse që e provojnë ligjërisht këtë akt, Gjykata e Apelit të Tiranës, i ka konsideruar Fadil dhe Xhemile Toptanin në mungesë, duke i klasifikuar të gjallë dhe ka vijuar procesin, duke shkuar në vendimmarrje dhe duke dhënë një vendim në favor të paditësve Basha.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin e saj të vitit 2014, kishte rrëzuar padinë e paditësve Basha, ndërsa Gjykata e Apelit, ka rrëzuar vendimin e Shkallës së Parë dhe ka vendosur në favor të paditësve.

“Kjo ndodh në këtë çështje të nxehtë në Tiranë ku janë duke ndërtuar dhe investuar pallate palët paditëse, ndaj ndoshta Gjykata nuk ka pasur kohë mjaftueshëm, të marrë vendim për të gjallët. Një histori ku vettingu, mund të marrë përgjigje më të qartë për shkelje të tilla që konsiderojnë të vdekurit të gjallë”, shkruan Çollaku.

REDAKSIA E GAZETËS



# Vettingu tërbon hajdutët në Parlament: Lulzim Basha i bën presion Edi Ramës me hetim për pasurinë përrallore të gruas së kryeministrit

Nga Sokol Pepushaj

Vettingu, të cilin asnjë nga politikanët, pushtetarët apo segmentet e drejtësisë nuk e kuptuan kur 140 deputetë i thanë ok me votën e tyre, tashmë është bërë i kuptueshëm për të tërë. Shpresa e tërë spektrit politik e legislative se Vettingu do përcillej me metoda turkoshake nëpër kalendrat greke, siç janë mësuar përgjatë tërë historisë së zezë të shtetvjedhjes shqiptare, tashmë ka vdekur dhe kjo ka acaruar që nga ai ish kryekomunari i vogël e deri tek kryeministri. Kazani, ku çdo gjë e vjedhur do kthehet në vëndin e vet. i ka tërbuar të gjithë, të cilët janë vënë në radhë që të shtyjnë drejt sekuestros e burgut njëri-tjetrin, duke fshehur kokën si struci.

Nga foltorja e Parlamentit, shefi i opozitës ka sulmuar ashpër kryeministrin, duke akuzuar familjen kryeministore për korrupsion galopant. Kryeministri Rama i ka konsideruar absurde akuzat dhe kërkesën e fortë të opozitës për ngritjen e një komisioni për hetimin e "ABI Bank", ku Linda Rama, bashkëshortja e kryeministrit është në krye të Këshillit Drejtues të kësaj banke.

Në fakt, mjafton një deklaram i tillë për të qartësuar se akuzat diçka mba-



jnë brënda vetes, edhe pse ne foltore përdoren për presion vetëmbrojtës.

Sipas shefit të opozitës Lulzim Basha, gruaja e kryeministrit Rama është suport i fuqishëm i ABI BANK, e cila ka në përbërjen e tij dy investitorë rusë, të pasurive të patundshme.

Është kjo një akuzë shumë e rëndë që edhe pse sot kaloi si të tjerat, pra pa përgjigje nga kryeministri dhe pa nisje hetimi nga prokuroria, normalisht që për ndërkombëtarët flet jo pak.

**Ja pak teatër parlamentar:**

“Mos qeshni se nuk është për të qeshur iu thashë edhe kolegëve të tu. Dhe i vetmi që s’qesh se e di shumë mirë është lideri dixhital dhe nuk e ka nga kazani dixhital arsyen e mosqeshjes. E ka të qartë shumë ai dhe parndaj jam si rrallëherë dakord me të se partia Demokratike këtu nuk hyn. Këtu je vetëm përballë shqiptarëve dhe nuk i ikën dot kësaj, duke thënë hajde bëjmë një komision parlamentar dhe të hetojmë "ABI BANK", investimin më të madh amerikan në Shqipëri ,

se i bie pastaj që të bësh për budalla gjithë planetin. Këto historitë e tua se ky investitor ka lidhje me rusët, këto janë pastaj përtej asaj  $7 \times 7 = 42$ . Këto janë më keq. Këto nuk i lejohen as një karrocieri të dehur dhe të zhgënjyer nga partia demokratike në një klub të humbur të një fshati ku s’ka rrugë , e jo më kryetarit të partisë demokratike, liderit të alternativës”, tha Rama si përgjigje për vjedhje nga gruaja e tij...



# Shkodër: Terroristë me maska sulmojnë për të vrarë një emigrant

Dje në qytetin verior, ditën për diell, rreth orës 10 e 30 minuta, në mes të qytetit, përballë Katedrales së Shkodrës, tre persona me maska, kanë terrorizuar qytetërit dhe kanë dhunuar fizikisht një emigrant, i cili ishte kthyer nga Amerika vetëm një ditë para ngjarjes. Është dhunuar barbarisht, sa është përgjakur vëndi, emigranti Vitor Pukri. Dëshmitarë në vëndin e ngjarjes, të cilët kanë frikë të identifkohen për gazetën, deklarojnë se tre personat me maska kishin qëllim ta vrasin viktimën, por dy persona të rastësishëm, kanë ndaluar makinën e tyre dhe janë konfliktuar fizikisht me dhunuesit për të mbrojtur jetën e emigrantit dhe kanë arritur ta marrin viktimen të përgjakur dhe pa ndjenja dhe ta futin në makinën e tyre, duke u larguar

me shpejtësi dhe pa adresë. Dy pesonat, identitetin e te cileve nuk e mesuam, i kanë shpëtuar jetën, por nuk dihet ku e kanë çuar emigrantin Pukri.

Përmes burimeve në polici, mësohet se Vitor Pukri kishte rreth 17 vjet që nuk jetonte në Shqipëri, pasi kishte jetën e rrezikuar nga grupe mafioze me prapavijë terroriste islamike, të cilat prej shumë kohësh e kanë futur në rreth të kuq për ta vrarë.

Mësohet gjithashtu se Pukri nuk ka asnjë të afërm në Shqipëri dhe se pak minuta para ngjarjes kriminale kishte kërkuar ndihmën e Komisarariatit të Policisë së Shkodrës për ta paisur



me dokument identiteti për të shkuar në Itali tek të afërmit e tij. Pra, sapo ka dale nga Komisarati i Policisë, tre personat me maska e kanë qëlluar dhe kanë tentuar ta vrasin. Ngjan sikur nga brenda policisë, grupi terrorist është lajmëruar për ti bërë pritë dhe për ta eliminuar fizikisht emigrantin Vitor Pukri.

Dhe Policia e Shtetit është sektori më kriminal këto vitet e fundit, ku edhe ish Ministri i Brëndshëm Saimir Tahiri është nën akuzë si bos i mafies së drogës, të cilin po e mbron haptas kryeministri Edi Rama, i akuzuar edhe ai për korrupsion dhe lidhje të ngushta me mafian e drogës dhe me grupe ter-

roriste islamike. Një studim i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, i mbështetur nga Ministria e Jashtme e Holandës, ka gjetur se policia shqiptare është institucioni më i korruptuar në vënd.

Krimi në Shqipëri sot kontrollon gjithë sektorët e jetës, që nga polici më i thjeshtë, tek gjyqësori, deputetët, ministrat dhe akuzat janë shumë të rënda edhe për kryeministrin dhe Presidentin e Republikës. Po dje, Ambasadori amerikan në Tiranë Donald Lu, ka bërë një deklaratë të fortë, duke thënë se drejtues të shtetit kanë trafikuar qenie njerëzore dhe se kriminelët me pushtet duhet të arrestohen sa më shpejt.

Redaksia e Gazetës

## Vetting-u: Edi Rama drejt fundit të pashmangshëm, por ende vazhdon me korrupsionin kryeministrot!

Nga: **Spartak Ngjela**

Reforma në Drejtësi duhet të shpejtohet në ecurinë e saj; dhe politika amerikane duhet të fillojë denoncimin e fakteve realë, ashtu sikundër që bëri për aferën e Bashës me politikën ruse, se sot janë të bashkuar të dy krahët e korrupsionit. Por kanë frikë të dalin hapur. Pikërisht kjo frikë duhet të shfrytëzohet nga politika amerikane.

Shikoheni gjetjen absurde por korruptive të Teatrit Kombëtar.

Zotërinj; Teatri Kombëtar si objekt i kulturës së lartë nacionale, është dhe duhet të jetë patjetër vepër e shqiptarëve dhe jo vepër apo prodhim i tregut.

Edi Rama kërkon ta krijojë Teatrin Kombëtar si prodhim tregu, bashkë me klientelën e tij dhe klientelën e Sali Berishës.

Jo, zotërinj, për ndërtimin e një vepre kombëtare të kulturës së lartë çdo kryeministër i drejtohet shoqërisë vet që të kontribuojë në financimin e tij në një donacion mbarëkombëtar. Rruga e interesit tregtar është rrugë antikom-bëtare dhe nuk ka moral.

Këtu, në këtë proces do shkojë interesi i shoqërisë shqiptare në përgjithësi, sepse është vepër kombëtare. Kurse, kapitali i madh shqiptar, po të ketë ca pak ndjenjë kombëtare sigurisht që paguan pjesën më kryesore për ndërtimin e një vepre të kulturës kombëtare e cila duhet t'i rezistojë kohës deri dhe në një shekull e më tej.



Kjo është e vetmja rrugë që ndalon korrupsionin kryeministrot.

Si mendon ky kryeministër i apasionuar kundrejt korrupsionit, një milionë shqiptarë që do të marrin pjesë si donatorë në një proces strikt ligjor, nuk mund të paguajnë dot 30 milionë apo 40 milionë Euro?

Sigurisht që po. E pra; vetëm kësh-tu Teatri Kombëtar si godinë do të jetë një prodhim kombëtar dhe jo një prodhim tregu.

Për faktin që ndërkohë kanë filluar goditjet e para të korrupsionit shqiptar, vetë opinionin publik shqiptar, deri tani skeptik, ka filluar të lëvizë drejt

optimizmit.

Por duhet ende dhe më shumë shpejtësi në veprime. Politika amerikane duhet të fillojë me presion kundrejt kryeministrit shqiptar që ligji për vettingun e politikanëve të hyjë në Parlament sa më shpejt që të jetë e mundur.

Në të njëjtën kohë duhet që politika amerikane të ekspozojë të gjitha faktet që disponon kundrejt korrupsionit shtetëror të niveleve të larta, dhe duhet të influencojë kundrejt OMN-së që kjo të shpejtojë procesin e pastrimit të korrupsionit aktiv që është sot ende prezent në drejtësinë shqiptare, në mënyrë që të fillojë formulimi

i kompozimit të Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatës së Posaçme, të cilat kushtetuta i ka ngarkuar me detyrën e veçantë të hetimit dhe gjyqimit të nivelit të lartë të korrupsionit kryeministrot në Shqipëri.

Goditja që u dha sot në Bashkinë e Lezhës ishte një lëvizje e thellë profesionale kundër krimit dhe korrupsionit, se shumë shpejt do të dalë që Lezha është realisht një grupë e qullët ky janë përzierë të gjitha palët.

Gjithsesi; shenjat janë që, këndeje e mbrapa, do të kemi vazhdimisht goditje të reja.

# Kjo është epoka Donald Trump/ Nisin hetimet ndaj George Sorosit, fillimisht për financat në Rumani dhe Kolumbi



Nis tashmë hetimi ndaj miliard-erit George Soros dhe Fondacionit të tij “Për një shoqëri të hapur”.

Sipas asaj që raportojnë mediat e huaja, gjyqësori njoftoi sot se Organizata për Lirinë e Informacionit (FOIA) ka ngritur padi kundër Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për të dhënat lidhur me financimin e tyre nga aktivitetet politike të “Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur Soros” në Rumani dhe Kolumbi.

Akuzat kanë të bëjnë lidhur me dyshimet dhe transaksionet që kanë kaluar nga Departamenti Amerikan i Shtetit drejt fondacionit të miliarderit, fonde këto që dyshohet të kenë kaluar përmes USAID dhe që janë përdorur në mbështetje të politikave dhe interesave të miliarderit, në vende të ndryshme të botës.

“Është koha që amerikanët të lejohen të shohin dokumentacionin e Departamentit të Shtetit në lid-

hje me financimin publik të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur Soros,” tha Presidenti i Gjyqësorit Tom Fitton.

“Miliarderi George Soros ka nevojë për zero ndihmë nga taksapaguesit për të promovuar axhendën

e tij të largët jashtë shtetit”, theksoi ai

Mediat e huaja, theksojnë se pjesë e këtij hetimi pritet të jenë edhe vende si Maqedonia dhe Shqipëria, për të cilat prej kohësh ka dyshime të forta për ndikim të So-

ros në politikbërjen e dy vendeve të Ballkanit.

Ish-Kryeministri i Maqedonisë Nikola Gruevski kërkoi një “desorozim” të shoqërisë. Në shkurt të vitit 2017, u raportua se qeveria e SHBA ka shpenzuar në



United States Senate  
WASHINGTON, DC 20510

The Honorable Rex W. Tillerson  
Secretary of State  
United States Department of State  
2201 C Street NW  
Washington, D.C. 20520

March 14, 2017

Dear Secretary Tillerson:

Congratulations on your recent confirmation as Secretary of State. We look forward to working with you on the numerous foreign policy issues facing our nation in the years to come.

As you are undoubtedly aware, Macedonia has been entrenched in a process of building its own coalition government after elections held in December of 2016. Unfortunately, we have received credible reports that, over the past few years, the U.S. Mission there has actively intervened in the party politics of Macedonia, as well as in the shaping of its media environment and civil society, often favoring left-leaning political groups over others. We find these reports discouraging and, if true, highly problematic.

Several letters were recently sent to the U.S. Ambassador to Macedonia inquiring into the role the U.S. Mission to Macedonia plays in the distribution of U.S. foreign aid in Macedonia, the ongoing and sometimes tumultuous Macedonian political landscape, and in shaping Macedonia's media environment and civil society. The responses to these letters have not alleviated our concern.

Much of the concerning activity in Macedonia has been perpetuated through USAID funds awarded to implementing entities such as George Soros' Open Society Foundations. As the recipient of multiple grant awards and serving as a USAID contractor implementing projects in this small nation of 2.1 million people, our taxpayer funded foreign aid goes far, allowing Foundation Open Society – Macedonia (FOSM) to push a progressive agenda and invigorate the political left. Our foreign aid should only be used to promote a political agenda if it is in the security or economic interests of our country to do so, and even at that, we must be cautious and respectful in such an endeavor. We should be especially wary of promoting policies that remain controversial even in our own country and that have the potential to harm our relationship with the citizens of recipient countries.

This problem is not limited to Macedonia, but appears to follow a pattern of alarming activity in this volatile region. Respected leaders from Albania have made similar claims of US diplomats and Soros-backed organizations pushing for certain political outcomes in their country. Foundation Open Society – Albania (FOSA) and its experts, with funding from USAID, have created the controversial Strategy Document for Albanian Judicial Reform. Some leaders believe that these "reforms" are ultimately aimed to give the Prime Minister and left-of-center government full control over judiciary power.

heshtje miliona dollarë nga taksat e qytetarëve, për të destabilizuar qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike, në qendrën e djathtë në Maqedoni në bashkëpunim me George Soros.

Ndërsa sa i përket Shqipërisë, dyshimet ngrihen se paratë e shtetit amerikan, kanë shkuar përmes US-AID, për të ndikuar në mbështetje të interesave të ngushta të miliard-erit me politikë të majta në vendin tonë.

Ky dyshim u ngrit në mars të vitit 2017, nga gjashtë senatorë amerikanë, në një letër drejtuar sekretarit të shtetit Rex W. Tillerson, të cilët i bënë thirrje të hetojë marrëdhëniet mes USAID-it dhe fondacioneve Soros.

Kjo pasi sipas tyre, dollarët e tak-sapaguesve amerikanë po përdoren nga Departamenti i Shtetit dhe US-AID-i për të mbështetur interesa të ngushta, që kërkojnë të imponojnë politikë të majta në vende të tilla si Maqedonia dhe Shqipëria.

Por akuzat për Soros dhe ndi-kimin e tij në politikën e vendeve të ndryshme, qoftë duke përdorur administratën Obama dhe taksat e amerikanëve ka pasur edhe më herët.

Në shkurt të vitit 2017, Laura Silber nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur dënoi "qeveritë joliberalë"

në Ballkan, si Maqedonia, Shqipëria dhe Rumania, duke thënë se më herët kishin punuar kundër OJQ-ve të Soros.

Ashtu si në pjesë të tjera të botës, një numër i entiteteve dhe projekteve të financuara nga Soros në Rumani gjithashtu financohen nga qeveria e Shteteve të Bashkuara.

Në Rumani, në mars 2017, kreu i partisë qeverisëse njoftohet se akuzoi se fondacionet e Soros "që nga viti 1990 kanë financuar të keqen".

Sipas të dhënave të publikuara nga mediat e huaja, në vitin 2016 Fondacionet e Shoqërisë së Hapur Soros dhanë më shumë se 3.3 milionë dollarë për organizatat në Kolumbi. Disa nga këto organizata janë mbështetur financiarisht nga qeveria e Shteteve të Bashkuara, duke marrë më shumë se 5 milionë dollarë nga Departamenti i Shtetit, USAID dhe Fondacioni Inter-Amerikan (një agjenci federale).

Një nga subjektet e financuara nga Soros, një organizatë pro-LGBT, gjithashtu u përzgjodh nga Fondacioni Inter-Amerikan, si një organizatë partnere në nismën e projektit të paqes në Kolumbi.

**Sakaq, hetimi që ka nisur, pritet të përfshijë fillimisht vende si Rumania dhe Kolumbia.**



# Triptiku i laryshisë

Nga EDI RAMA

Mund të quhej vetëm Mehmet mbetja zeshkane e një bashkimi midis dy qenieve lëkurëzeshkëta që pas një nate të rrokopushme dashurie u bënë prindërit e tij. Ishin dy krijesa kaq të ngjashme njëra me tjetrën, sa zgjohnin krejt admirimin tim. I admiroja, sepse më ngjanin si vëlla e motër dhe një ngjashmëri e tillë ishte për mua kulmi i harmonisë së çiftit. Ai i jati i Mehmetit, me ca sy të mëdhenj si një e verdhë e zezë veze, hundë të përthyer shqiptonjë prej stërnipi

shoqin, mustaqe të ndrojtura dhe flokë përherë të shpupurisur mbi të cilët, sa herë hyja në shtëpinë e shokut tim të klasës, gjeja një bikutinë metalike që endej lart e poshtë, duke u rrekur më kot t'i adaptonte për një lok gruajë të nderueshme.

Organizata e Pionerit më kishte ngarkuar që të shpëtoja Mehmetin prej duarve të armikut përmes zbatimit të përpiktë të një lloj misioni që gjatë asaj epoke të artë quhej "patronazh".

Ishte një nga termat e rëndomtë të atyre kohërave të mbingarkuara me iniciativa, betime njerëzore, orë të

dëshpëruese në mësim. Duke marrë ato katrat e tij pakaluese, shoku im i klasës që katandisur në tabelë qitjeje e armiqve të socializmit, ndërsa unë, sipas parrullës revolucionare. "Dhjetat tona janë plumba në ballë të armikut" kisha shtrirë përdhe një batalion të tërë syresh. Gjithëherë kaloja përballë tabelës së kuqe të nderit, në hyrje të shkollës, dhe shihja fotografinë time të rradhitur midis pionerëve të daluar e buzagaz, përfytyroja me krenari dëmet e panumërta që kishim shkakuar në kampin armik me dhjetat tona, pa mudnur gjithsesi ta mposhtja kre-

klasës në një killer intelektual që pastaj do të bënte kërdira ngjethëse me ato dhjetat e tij aq të largëta e utopike, zgjaste aq kohë sa i nevojitej Mehmetit për të kopjuar mekanikisht detyrat e mia, ndërkohë që unë lexoja me zell "Si u kalit çeliku". Ishte një best-seller i madh i letërsisë sovjetike të propagandës që më dukej tejet i efektshëm për të motivuar Mehmetin në misionin tonë të përbashkët, por që tekembramja vlente vetëm për të kulturën time bolshevike, sepse porsa mbaronte së kopjuari, Mehmeti hapte televizorin duke më fuar të shihnim së toku shalë dhe cica nëpër reklamat e jugosllavit dhe ia merrte përpikmërisht të njëjtë refren pyetjesh mbi shoqen time të bangës, pa e çarë kokën asfare që unë skuqesha gjer në vesh.

Teksa vinte vërdallë nëpër dhomë, duke kërkuar me antenë pikën e vdekur (asokohe qarkullonte miti se në çdo dhomë ka një pikë të vdekur ku zhurmuesit nuk futen dot e ku shëmbëlltyra televizive turbullaur prej tyre kullohet si me magji, në këtë pikë mund të shihej rehat jo vetëm jugosllavi, po edhe e shumëndërruara Rai) rrekej dhe të më bindte se kishte ardhur çasti që qysh të nesërmen t'i fusja duart Inës. Mehmeti mbronte mendimin se ky ishte i vetmi veprim që duhet ndërmarrë si kundër ndrojtjes sime prej çun mami ashtu edhe për të zgjuar tek Ina ndjesinë e kënaqësisë seksuale. Vetëm, pasi ta hidhja këtë hap mund të shpresoja ta bindja Inën që të vinte me mua tek Gjiri i Kurvave, një vend tërheqës për fantazinë time të epokës ku zhvillohet ngjarja, një lloj gjuhëze ujore që kafshonte thellë kodrat e Liqenit Artificial të Tiranës. Shkonim shpesh për t'u larë atij liqeni dhe, edhe pse nuk kisha parë kurrë ndonjë kurvë që të shfaqej mes pemëve a të dilte nga uji për të ndjellë ndonjërin prej nesh, nuk guxoja të pyesja më gjatë për hollësira nga frika se Mehmeti më vinte në lojë. E kështu mjaftohesha me të tundura aprovuese të kokës e me një ngerdheshme që nënkupton, "Lëre atë mrekulli" i bindur sidoqoftë që, pas rënies së diellit, në atë gjë të rëndomtë garipat jetonin çaste bote.

Pikëpyetja që rritej përditë në kokën time ishte ajo që kërkonte përgjigjet për çka ndodhte konkretisht kur dy qenie seksesh të ndryshme gjendeshin lakuriq përballë njëri-tjetrit, i bezdisur nga pamundësia e skajshme për të kuptuar atë që djali duhet të bënte me trupin e zhveshur të vajzës e njëkohësisht edhe nga paafësia ime e dukshme për të qenë ndryshe nga stereotipi i një çuni mami, fakte kokëforta këto që sipas meje e shtynin zgjidhjen e enigmës për ditën e martesës, optoja për një martesë goxha të parakohshme, derisa një ditë të bukur vendosa t'i kërkoj dorën shoqes time



të një ushtari turk, që ka gjetur netë kënaqësie të ndaluar rrëzë ndonjë kodre koçimare në Shqipëri, mustaqe të bollshme që i lëpinte parreshtur buzë të mishta dhe mjekër të mprehtë thikë, ndërsa ajo e ëma, sy ngahera të shqyer habie prej bëmave të djalit të pandreqshëm, hundë simetrike me të

tëra edukate morale e politike, punë prodhuese, kalitje fizike, pushimi aktiv, kritikë e autokritikë revolucionare, shenjash sulmuese e ku ta di unë se çfarë akoma. Patronashi i konsistonte në ndihmën e përditshme që si i parë i klasës duhet t'i jepja Mehmetit, për të përmirësuar rezultatet e tij

jtësisht shqetësimin që më lindte aty për aty, për shoqen time të bangës, e cila merrete vetëm nënta, notë që sipas mësueses kujdestare edhe pse e plagoste rëndë armikun i linte shteg për të rimarrë veten.

Në fakt, çdo seancë patronazhi për ta transformuar shokun tim të





të bangës. Nëse nuk e bëra, kjo natyrisht për shkak të ndërhyrjes së vrazhdë të Mehmetit. Shoku im katranjos, i cili ishte i bindur se burri nuk duhej të martohej përpara se të kalonte nën shtatë palë shalë dashnoresh, e përjashtoi pa mëshirë hipotezën e martesës sime, sepse jo vetëm që unë nuk e kisha kaluar provën e zjarrit, për më tepër Ina ishte e bukur. Gruaja duhej marrë sa më e shëmtuar nëse s'doje të ta merrnin të tjerët. Megjithatë, nga ana ime nuk kuptoj që të jem dorëzuar, por qysh atëherë qesh shumë më i matur në shprehjen e asaj dëshire cfilitëse që ishte për mua martesë, duke vuajtur kështu peshën gjithnjë e më të rëndë të pikpyetjes.

“M’tregun çunat e lagjes se ai filmi mrom kishte qenë bota fare”, më tha një ditë Mehmeti, i cili shoqërohej me djem gjashtëmbëdhjetë-shtatëmbëdhjetë vjeçarë. Ata i kishin treguar se, një natë më parë, “jugosllavi kishte hap një seri filmash me t’qime. “Nuk m’la ai shkërdhatë i degjenerum, vazhdoi Mehmeti, duke iu referuar të atit, “po e qita inotin t’u i ra me dorë. Kshu e boj sa herë qi ai mut m’çan bythën”. Aprovova me kokë pa e kuptuar mirë se kujt i kishte vënë dorën Mehmeti në shenjë proteste dhe misteri u bë më i madh kur pas interesimit tim rreth reagimit të prindërve teksa ky i binte me dorë, ai m’u përgjigj. “Qeke megjith men trap i modh!. Pse mër

para plakut ene plakës i bi me dor ti? Me siguri ky shkon në dhomën tjetër e përplas gjërat përtokë, mendova dhe nxitova ta pyes. “Po ç’kuptim ka t’i biesh me dorë kur je vetëm fare? “T’vjen lezeti mër jahu! Ç’a kuptimi më t’modh do ti?” “Si të vjen lezet ty?” e pyeta i çmeritur. “Myll syt, shof Inën ene i them Ina, Ina, hiqi brekët, punë minutash jom n’parajs. Po ty si t’vjen? M’u tha pështyma në gojë teksa përfytyroja me llahtarë shoqen time të bukur që zhvishej nën urdhërat e Mehmetit të egërsuar që i tundte para syve një shkop. Me gjysëm zëri iu përgjigja, “Edhe mua”.

Të nesërmen në mëngjes, gjatë pushimit të madh, Mehmeti vjen e më afrohet me një zë djallëzor. “A do t’vish ke rifuxho t’i fusim i t’rame me dor? M’u në mes të oborrit të shkollës gjendej një nga mijëra vendstrehimet që Enver Hoxha kishte ndërtuar për të mbrojtur pleq, gra e fëmijë nga bombardimet e imperialistëve amerikanë dhe social-imperialistëve sovjetikë, ku sot e gjithë ditën kutërbon mut e shurrë e ku asokohe djemtë e klasës së tetë futeshin për të pirë cigare. “Mirë” iu përgjigja i lumtur, sepse më në fund do të zhbëhej misteri që më kishte torturuar gjatë gjithë natës e që më kishte bërë t’i bija në ëndërr me grushta e shqelma një karrigeje, duke ulërirë, “Ina, Ina, hiqi brekët”.

I kam para syve edhe sot kokat e çunave të klasës së tetë nën fashëzat e zbehtë të dritës që depërtonin prej dy a tre vrimave të ajrosjes në tavan. Në rresht, ulur mbi çimenton e ftohtë njëri

bri tjetrit, mbështjellë nga një zhurmë e çuditshme, një lloj gugërime. Duke ecur qorrazi nëpër terr u afrova e u ulëm edhe ne, Mehmeti e pas tij unë. Fillova të kap ca fjalë të lëshuara si në jerm teksa ndjeja një lloj dridhjeje ritmike të trupës. “Zhvishu Marjeta, zhvishu se m’plase? Zhvishu o shpirti im, lene lalin ta shofi pak cicën e bukur si gjyle... Hiqe tutën zemër! Hiqe shpirt...Mos ki turp jemi vetëm, vetëm fare...Lene lalin ta preki pak kofshën e bardhë...”

Nuk ksishte pikë dyshimi që apeli i sinqertë i kolegut që drejtonte operacionin i drejtohej zyshës së fiskulturës që me ato tuta të ngushta që mbante arrinte të provokonte edhe ndërshëmërinë time të thellë prej zëvendëskomandanti çete.

Mehmeti u zbrëthye. “Jepi se do na dhjesi zilja”, më tha gjithë ankth, duke më shtyrë me bërryl. Duke u zbrëthyer si guak, i mbytur nën djersët e ftohta të një trupi të paprovuar, vështroja vjedhurazi nga shoku im i klasës. Fill-ova ta prek seksin tim teksa ndiqja instiktivisht dollibashin që ecte përpara, duke e kompaktësuar progresivisht dihatjen kolektive. “Do ta fus n’kërthizë do të ta fus”! Befas Mehmeti më futi gojën në vesh dhe më foli me vrazhdësinë e tij karakteristike. “Jo ashtu mër trap, kape për qafe!”. “Më bëhet shurra”, i thashë dhe u ngrita, gjoja i nervozuar prej pengesës së paparashikuar biologjike, duke ikur i tmerruar drejt daljes për të mos u kthyer më kurrë në atë tunel përveçse në rastin e ndonjë bombardimi anglo-amerikan.



# E drejta e pronës është pronësia mbi lirine tone

Nga Jorida Tabaku

Nëse duam të shohim se si një qeveri po sillet ndaj të drejtave të njeriut mjafton të shohim raportin e saj me pronën private. E shkuara e shoqërisë sonë mban mbi supe vuajtjen e shqiptarëve si pasojë e një sistemi që rrëmbeu dhe nuk e njohur pronën private. Jo më kot një figurë emblematike si James Madison ndërsa shkruante mbi pronën private nënvizonte se “Një njeri ka të drejtën e pronës njësoj siç ka një pronësi mbi të drejtën e tij”, prandaj çdo qeveri që përpiket që të tjetërsojë pronën e një qytetari ajo në fakt i merr qytetarit pronësinë e një të drejte që garantohet nga Kushtetuta dhe të Drejtat e Njeriut.

Rrëmbimi i kësaj lirie sot e kësaj dite po bëhet më evident nga qeveria socialiste e cila nisi rrugëtimin e vjedhjes që në maj të vitit 2015 kur solli në kuvend dhe votoi ligjin e Investimeve Strategjike. Tre vjet më parë e kam paralajmëruar këtë abuzim me pasoja të rënda mbi një nga të drejtat më themelore të njeriut, madje propozova dhe amendamentin përkatës që neni 26 i ligjit të shfuqizohej.

Sipas këtij neni, nëse një investitor me titullin strategjik (pra do të investonte mbi 50 milion euro) nuk do të binte dakord për çmimin e tokës që duhej shpronësuar për investimin privat, qeveria do të ndërhynte duke ia marrë tokën pronarit me vlerën e ligjit për investime publike. Në fund do të ishte investitori privat që do të paguante këtë shumë dhe do të merrte me një vlerë shumë herë më të ulët tokën e një pronari privat për të ndër-tuar biznes privat.

Shembulli më i mirë është godina shtesë tek Hotel Tirana që do ndërtohet shumë shpejt ku pronarët u dëmshpërblyen me vlera qesharake nga qeveria dhe bashkia e Tiranës pas këtij ligji dhe tanimë ajo tokë i është dhënë një investitori privat.

Hapin tjetër në drejtim të pronarëve dhe mbi të gjitha në drejtim të së drejtës së pronës, qeveria e ndërmori ku solli në kuvend ligjin e ri për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Një ligj i miratuar në mes të natës në mënyrë hajdutëshe, siç bëhen punët e këqija në këtë vend. Ligji që më pas u shfuqizua pjesërisht nga Gjykata Kushtetuese, nuk e njeh konceptin e pronës, i jep pushtet qeverisë që të kompensojë vetëm 20% të vlerës, merrte fondin e



pronave të pronarëve për t’ia kaluar ministrisë së bujqësisë apo për t’iu dhënë klientëve të mbetur të qeverisë me vlerë 1 euro/metër katror.

E për të përmbyllur ciklin shkatërrimit të konceptit të pronës dhe vjedhjes së Pronës, qeveria është angazhuar që të formulojë një VKM e cila nënvizon se pronat në zonat bregdetare nuk do t’i kthehen pronarëve. Sipas VKM-së, qeveria zotohet që këto prona t’ua japë me përparësi

investitorëve strategjikë (që me këtë VKM s’duhet të paguajnë asnjë lek).

Qeveria po zhbën një herë e mirë jo vetëm drejtësinë tranzicionale ndaj pronës por mbi të gjitha edhe vetë pronën. Atë ajo ka ndërmend t’ua shpërndajë oligarkëve që nën petkun e investitorëve strategjikë u shmangen taksave (që i paguajnë qytetarët edhe për to), fitojnë pronat e pronarëve për pako gjë apo edhe falas duke u pasuruar në kurrizin e trashëgimisë së

pronarëve. Asgjë më pak se sa ajo që ka ndodhur në këtë vend nga viti 1945 e deri në 1990.

“Kudo ku ka një eksese të pushtetit, prona e çdo lloji nuk respektohet. Në një qeveri të tillë askush nuk është i lirë të shprehë mendimet e tij, nuk është i lirë të jetë ai që do apo të ketë pronësi mbi liritë e tij” e përfundon Madison esenë e tij mbi liritë dhe rëndësinë e pronës.



# Luigj Gurakuqi tribun i lirisë, demokracisë dhe i përparimit

*Veç një qëllim i naltë t'ban me durue  
e zemrën t'a forcon,  
ndër kundërshtime s'vjen kurr' me u lig-  
shtue  
mjer' ai që nuk qëndron!*

Luigj Gurakuqi është një ndër personalitetet më të shquara të historisë mijërvjeçare Shqiptare. Ai ishte njohës i përkryer i gjuhës e i letërsisë shqipe, poet, prozator, publicist, mësues, ekonomist, poliglot, politikan dhe burr shteti i shquar. Kontributi i tij nuk ka të krahasuar.

Erdhi në jetë me 19 shkurt 1879 në "gjirin" e një familjeje shkodrane me tradita qytetare e patriotike. Në vendlindje kreu arësimin fillor ndërsa shkollën e mesme në Kolegjin e "Shën Mitër Koronës" në Itali me mësues De Radën, për të cilin ruajti deri në fund të jetës një admirim të veçantë. Përfundoj studimet universitare në Napoli (Itali) në vitet 1901-1906 ku debutoi me sukses si poet lirik, lëvruer i prozës së shkurtër e publicist.

Nga viti 1906 u rreshtue në ballë të luftës për çlirim nga vargonjtë shekullor të "Portës së Lartë". Në të gjitha zigzaget e historisë u orientuar drejtë duke mbetur simbol i përkushtimit deri në vetmohim për atdheun e robëruar. Ai ndjente dhimbje e revoltë nga padrejtësitë e klasave sunduese në kurriz të vegjelisë e të shtresave të tjera të pambrojtura të shoqërisë shqiptare. Më 1908 në Kongresin e Manastirit u zgjodh nënkryetar dhe anëtar i komisionit për njësimin e alfabetit shqip me shkronja latine. Në vitin 1909 ishte drejtor i parë i Shkolles së Mesme Normale të Elbasanit ku dha një kontribut të vyer për vënien e arësimit shqiptar mbi baza kombëtare e laike. Më 1911 merr pjesë në kryengritjen e malësorëve të Mbishkodrës dhe, si një nga udhëheqësit kryesor të saj, hartoi së bashku me Ismail Qemalin Memorandumin e Greçës. U ndodh në radhët e para për shpalljen e Pavarësisë të Shqipërisë, me 28 Nëntor 1912 duke qenë bashkëpunëtor më i afërt e besnik i Ismail Qemalit.

Biri i shquar i Shkodrës u emëru ministër i arësimit në Qeverinë e Përkohëshme të Vlorës. Në Luftën e Parë Botërore, gjatë pushtimit Austro-Hungarez, duke shfrytëzuar postin e drejtorit të përgjithshëm të arësimit dhe koniukturat politike, hapi shumë shkolla shqipe. Në kongresin e Durësit me 1918 zgjidhet ministër i arësimit dhe anëtar i delegacionit

shqiptar në Konferencën e Paqës në Paris. Në vitet 1921-1924 deputet i Shkodrës në Këshillin Kombëtar dhe një nga udhëheqësit kryesor të opozites demokratike për demokratizimin e jetës së vendit, zhvillimin ekonomik e kulturor dhe mbrojtjen e atdheut nga synimet grabitqare të fuqive imperialiste.

Në qeverinë e Fan Nolit emërohet Ministër i Financave. Ai në çdo situatë karakterizohej nga ndershmëria, korrektësia, kompetenca profesionale dhe ndjenja e lartë e përgjegjësisë për krijimin, forcimin e konsolidimin e shtetit të ri demokratik shqiptar. Pas shtypjes së Revolucionit të Qeshorit shkoi në Itali. Më 2 mars 1925 u vra në Bari prej një mercenari të shitur në shërbim të forcave reaksionare që erdhën në fuqi.

Heroi dhe Mësuesi i popullit luftoj me guxim e trimëri deri sa dha jetën për një Shqipëri të lirë e të pavarur, i cila nëpërmjet reformave progresiste demokratike të zhdukte prapambetjen e madhe dhe të fitonte kohën e humbur gjatë shekujve të robërisë.

## QËNDRESA

Me gusht shkon vapa e me djelmi kalojnë gjith' prallat e kohës s're.  
Si n'dimën bora dhenë, kryet na zbardhojnë vjetët e kujdeset ne.

Me lule t'ershme e larca m'dukej shtruce bota, sa ish' i ri  
N'gaz m'shkonte jeta, e s'm'nepej kurr m'u ankue,  
kurr zemra s'm'ndjellte zi.

Andra t'kandshme m'livrojshin nëpër mend si flutra pa ja da.  
T'lum si vedin nuk njifshë tjetër kend nuk dijshe kurr me kja.

Por andrrat sot kaluen, prallat djelmore janë zhdukun e kanë tretë.  
Ideve t'bukura, shtresave lulzore veç emni u ka mbetë.

Oh jeta përnjimend me rrena e vaj plot qenka n'kët botë l'lashtë!  
U shueka tepër shpejt lakmim' i saj, si zjarrmi i bam me kashtë.

Veç një qëllim i naltë t'ban me durue,  
e zemrën t'a forcon,  
ndër kundërshtime s'vjen kurr' me u lig-shtue,  
mjer' ai që nuk qëndron!

Kur Fan S. Noli mori lajmin e kobshem, me zemër të pikëlluar hartoi një poezi për bashkëluftëtarin e tij që bëri kaq shumë për "Nanën Shqipëri".

**SYRGJYN-GJALL  
E SYRGJYN-VDEKUR**

*(Elegji për Luigj Gurakuqin)*

Nëno moj, mbaj zi për vëllan,  
me tre plumba na i ranë,  
na e vran' na e shanë,  
na i thanë tradhëtor,

Se të deshte kur s'të deshnin,  
se të qante kur të qeshnin,  
se të veshte kur të zhveshnin,  
nëno moj, të ra dëshmor.

Nëno moj, vajto, merr malin,  
larot ta përmbysën djalin  
që me Ismail Qemalin  
ngriti flamurin trimëror.

Nëno moj, ma qaj në Vlorë  
ku të dha liri, kurorë,  
shpirt' i bardhë si dëborë  
ti s'i dhe as var për horr.

Nëno moj, ç'është përpjekur  
gojëmjalt' e zemërhekur,  
syrgjyn-gjall' e syrgjyn-vdekur,  
ky Vigan Liberator.

## NË KUVEND U ÇUE NJË BURRË

Në Kuvend u çue një burrë  
që i dha lajmin Shqipërisë:  
Që sot me këtë flamur  
thyem prangat e robnisë.

Nga të gjithë u ba një be:  
Shqipëria asht e jona,  
për liri dhe për atdhe  
flakë i bajmë zemrat tona.

Ball për ball atje në Krajli  
fjala e jote peshoi randë,  
ju kërkue vetëm liri  
pa zaptue, pa tiranë.

Gurakuq të kemi pranë  
në çdo zemër ke një vend,  
që kudo anembanë  
dritë i jep kombit tend.

## SHTEGTOJNË DALLËNDYSHET

Nuk e di zog i shtrenjtë  
Që afër mejet fluturon  
A do të mundësh me e gjetë  
Mërgimtarët kush i dëbon?

Fatkeqit i vdiq gruaja  
Duke u ngjitur për litar  
Në mes valëve shkoj e shuemja  
Atje është varri i saj.

Në thellësitë e territ të natës  
Qindra njerëz hypen në vapor  
Vajza e vogël kërkon nanën  
I fshinë lotët me shami në dorë.

Britma fëmijësh, oh sa siklet!  
Nga tmerrit nuk kanë gjumë  
Në mes tyre një grue thërret:  
"Burri im mori fund"!

Tyyy...tyyy... ushton vapori  
Është bërë gati me u nisë

Na"pushtoi" kudo mizori!  
Vendin tonë me e braktisë!

Jam dallëndyshja ciu, ciu  
Ah, zemra ime e shkretë!  
Shumë të këqija i vijnë njeriut  
Nga lubitë në tokë dhe në det!

Medet, ç'është kjo përplasje?!  
Po na futet uji mbrenda!  
Na mbyten djajtë me dashje!  
O Zot, ç'don këtu tek ne vdekja?!  
Mizoria nuk ka limit!  
Tmerr i madh kudo në sallë!  
Dikush lutet me gjithë shpirt!  
Kurse tjetri shpërthen në vaj!

Disa herë e mjera nanë  
Dallëndyshet fluturuan mbi det  
Ato krahët i përplasen në valë  
U bën gati për me "vdekë"!

Nana babe- erdhi dallëndyshja  
Ajo qënka shumë e bukur!  
Po bir-përgjigjet gjyshja  
Është si lule dhe si flutur!

Gjyshe u ban dy dallëndyshe  
Duan me ardhë në shtëpi  
Kërkojnë një jetë ndryshe  
A ti lejoj mbrenda me hy?

Shiko nanë si fluturojnë  
Janë krenare me dinjitet  
Ato jetën e fitojnë  
Me djersë të ballit ditë e netë.

Do të çojë me bagëtitë  
Atje lartë në shpat të malit  
Të ushqesh e të mjelësh dhitë  
Në qytet të sjellësh tamblin.

Kurse ti të shkosh në arë  
Çdo punë duhet të bësh  
Të jesh kurdoherë i parë  
Asgjë mangut mos të lësh.

Të prashitësh e të ujitësh  
Këtu tek ne nuk ka orar  
Të vjelësh e të kositësh  
Dhe pastaj të bësh mullar.

Menjëherë u çuen dallëndyshet  
Rreth e rrotull u shpërndan  
U tmerruen moj nana babe!  
E s'po dijnë në breg me dalë!

Është nata e mergimit  
Sherbëtorë në dyer të botës!  
Dhe "Poema e Mjërimit"  
Në "kerthizë" të Evropës.

Ç'është kjo fotografi?  
Nuk mund ta shikoj!  
Në dhe të zi Ti me hi?!  
E shkreta, kush të denoj?!

"Dallëndyshe" të paska vra  
Pjella e ndyrë e "Qytetërimit"!  
Çdo shqiptar duhet me të kja  
Me shpatë në dorë kundër kriminit.

*Përgatitur nga Luigj Temali*

# Trajtimi i veteranëve - testi më demokratik i një shoqërie civile

Aspak si mitomani, apo si nostalgjik i historisë në posthistori, por si kulturë dhe qytetari, madje si vlerë dhe standart demokratik, e kam parë dhe do ta shoh gjithë jetën time nderimin dhe vlerësimin ndaj atyre që kontribuan apo dhanë jetën për lirinë e kombit shqiptar në çdo pëllëmbë të Shqipërisë Natyrore, gjatë tërë historisë sonë vijuar me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare deri tek Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndryshe qoftë si aleatë dinjitozë të koalicionit progresist botëror, anglo-sovjeto-amerikan gjatë Luftës II Botërore, po ashtu të atij evropatlantik, prej të cilit, falë investimit të SHBA-ës dhe Natos, erdhi çlirimi i Kosovës nga regjimi gjakatar, millosheviçian, më 24 mars 1999. "Nderimi dhe vëmendja ndaj atyre që sakrifkohen gjakun deri edhe jetën për çlirimin nga cilado lloj shtypjeje dhe shfrytëzimi, kundër çdo lloj zgjedhe dhe mallkimi politik, siç ishte edhe ai i shqiptarëve të Kosovës nën robërinë diktatoriale, millosheviçiane, nuk është tjetër, sipas meje, veçse obligimi i përhershëm i cilitdo që, si demokrat i vërtetë, ndershmërisht, e do këtë vend, e do Evropën e Re, do të Ardhmen e lirë të popullit të vet dhe të popujve tjerë. Dhe, në kompleksin e kontributeve që shqiptarët kanë dhënë për liri dhe dinjitet kombëtar, kam vlerësuar dhe do të vlerësoj, krahas kontributit gandist rugovian, kontributin e luftëtarëve të lavdishëm të UÇK-ës, aleatët me fisnikë të SHBA dhe të Perëndimit për shpëtimin e një populli të vogël, si ai kosovar, nga thundra genocidale serbe, sidomos, gjatë viteve 90-të, maskradë që mori fund me Çlirimin e Kosovës. Me vetëdijen e dyshimit metodik, si kodi i komunikimit evropatlantik, se historia dhe posthistoria vazhdojnë të jenë fare pranë njëra-tjetrës, si vëllezërit siamezë, për ata që dehen nga sindroma e entuziazmit postmodern, sidomos për popujt e vegjël si yni, që ende nuk kanë arritur të zgjidhin Çështjen e tyre Kombëtare, injorimi, shpërfillja apo cinizmi vulgar me vlerat dhe kontributet historike vinë si mallkimi më i madh, ndaj vetvetes, në posthistori. Ndërsa po blija pranë një tregu ambulant, në qytetin e Koplikut, afrohet pranë meje një burrë rreth të 60-tave, me shikimin e përqëndruar tek libri monografik, "Bislim Kadri Bajgora" të Asllan Istrefit, ish-ushtar i UÇK-ës, që e mbaja në dorë. Me falni se nuk u njoh, -i drejtohem, por më bëri përshtypje përqëndrimi juaj tek libri. "Ju nuk më njihni, por unë u njoh "profesor" Kadriu", - plotësoi komunikimin tregtari ambulant. Lexoni libra, u pëlqejnë, e pyeta? "Ashtu me raste, -u përgjigj bashkëbiseduesi. Unë e njoh autorin e këtij libri, kemi qenë së bashku në UÇK në pranverën e "99-tës", - vijoi. Me të vërtetë, po e thoni këtë, e pyes?!?" Po, po këmbënguli me qetësi dhe dinjitet, madje me gradën e gjeneralit, por që përballë përndjekjes prej UDB-ës serbe, komunikoj edhe sot vetëm me pseudonimin "komandant Skifteri", si ish-anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-ës në Prishtinë. Komandant shtabi kishim Agim Çekun e Kosovës dhe zv.komandant Dilaver Gox-

hajn nga vendi amë. Kam njohur atje edhe Artan Sali Manin nga Reçi i M. Madhe, lindur në Koplik, efektiv i Brigadës nr.154, i cili jeton në kushte ekonomike mjaft të vështira, në një apartament, me qera, në Prishtinë, vetë i pesti, pa kurrfarë ndihme ekonomike, vetëm me një pension luftime prej 179 evro. Gjithçka detyrohet ta sigurojë me djersën e ballit, askush nuk do t'ia dijë se ishte njëri ndër luftëtarët e UÇK-ës. Ndërsa Admir Brahimi, një djalë i ri, nip në Koplik i Sipërm, u vra në luftën e Koshares, për çka shqyr, më në fund iu lidh një pension luftime prindërve të tij në Shkodër." Për veten time, -vazhdoi ish-komandant "Skifteri", -pas 27 vitesh shërbimi në ushtrinë shqiptare, edhe pse me Akademi Ushtarake të kryer, u largova vullnetarisht nga ushtria. Nuk kam pranuar pension luftime, sepse nuk shkova atje si mercenarët e sotëm, që shkojnë në vendet tjera, por iu përgjigja Thirrjes së UÇK-ës, kundër diktaturës gjakatare të Millosheviçit, sepse më thirri shpirti, shpirti i Kosovës së lirë. Me këtë ndjenjë dhe përkushtim do të jem gati tanë jeten time, në emën të bashkimit të trojeve shqiptare, por ajo që më shqetëson është fakti se vazhdoj të jem shumë i keqardhur për vël-lavrasjet mes ikonave të UÇK-ës, të cilët po vriten fatkeqësisht nga shqiptarfolësit e UDB-ës serbe"- përfundoi fjalën e tij bashkëbiseduesi. Ndërkohë Ç.SH, me pseudonimin "komandant Skifteri" më tregon një sërë fotosh në celular, me liderë kosovarë të ditëve tona, asokohe, liderët kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si me: Ramush Haradinajn, Agim Cekun etj. etj. sikurse edhe me ish-presidentin Fatmir Sejdiu. "Unë me gruan dhe tre fëmijët të moshës shkollorë jetojmë, thjesht, me biznesin tonë, por në Kosovë kam shokë e shoqe, shqiptarë kosovarë, a shqiptarë e shqiptare nga Shqipëria që jetojnë shumë keq, krejt të shpërfillur në fatin e tyre. Me ta komunikoj shpesh, por po vuajnë edhe sot në paqe, prandaj nuk i harroj dot", - vijoi fjalën e tij. "Ju jeni shkrimtar dhe gazetar profesionist, "profesor" Kadriu, ju ndjek me shumë simpati, prandaj dua t'u tregoj njërin nga rastet më të dhimbshme, sepse ndoshta edhe nuk po më besoni plotësisht", - më drejtohet mua me një shikim të thekshëm, drejt në sy. Ndërkohë ndërpret bisedën dhe më ofron receptorin e celularit: "Foli këtij gazetarit", -i thotë, shokut të vet të luftës, Hasan Began Halitit, bashkëshorti i një vajze tiranase, Valentinës, që, si u njohën në shkollën e mesme "A.Z. Çajupi" në Tiranë, martohen me njëri-tjetrin po aty, Valentina 17 vjeçe, kurse Hasani 26 vjeç, duke përfunduar që të dy, së bashku, në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Jam nga fshati Brojë, komuna "Skenderaj", fshati i Hashim Thaçit", -dëgjohet, nga ana tjetër e receptorit, Hasani. Nuk lamë pëllëmbë të kësaj zone pa e shkelur në luftë, nga Kosharja deri në Drenicë së bashku me Valentinën e cila u plagos në Klogdarmicë në 1999-tën, sikurse unë në 1996-tën, në dorën e djathtë për çka më shtruan në Spitalin Ushtarak në

Tiranë duke mbetur kështu që të dy invalidë, megjithatë askush sot nuk po do me ditë për hallin tonë. Edhe pse ishim në frontin e luftës, unë isha edhe komandant batalioni, me pseudonimin "komandant Kasemi", prej ditës së Çlirimit të Kosovës, 24 marsit 1999 deri në vitin 2001 mbetëm me një asistencë sociale prej 102 evro e 50 cent, prandaj në 2009-tën, së bashku me gruan ishim në krye të një proteste kundër qeverisë "Thaçi" për të na njohur statusin e veteranit të UÇK-ës si dhe të Invalidit të luftës, president ishte Fatmir Sejdiu. Megjithatë as protesta nuk na solli asgjë: as trajtim, as vëmendje, asnjë mbështetje. Vijuam të mbetemi me 170 evro për person nga statusi i veteranit, kurse asnjë perfitim si invalidë. Kam tre fëmijë, që ndjekin shkollën, i madhi per arkitekt në një shkollë norvegjeze, i dyti shkollën e mesme profesionale, kurse i treti atë fillore po në Skenderaj. Gruaja si e sëmure kronike, vuan nga hipocarcemia, në atë gjendje të rëndë aq, sa kur e kap kriza i duhet të qëndrojë, kudo të ndodhet, 3.5-5 orë e shtrirë. Ditën apo natën detyrohem ta dërgoj në spital, në Skenderaj a në Prishtinë. Vetëm gjatë 2017-tës jam detyruar ta dërgoj 3 herë brenda dy muajsh në sallën e reminacionit. Shpenzimet për shendetin e saj shkojnë 230 evro në muaj. Asnjë ndihmë në rastet më emergjente: as taksi, as ndihmë mjekësore, as ambulancë. 100 evro na kushton vetëm fatura të cilën mund të na e jap komuna Skenderaj për dy muaj, megjithatë, edhe pse jemi dy invalidë me tre fëmijë të moshë s shkollorë, as këtë faturë nuk na e përballon komuna, po nuk ia bëjnë me kohë kërkesën për 6 muaj. Të tjerat shpenzime janë: 60 evro për energjinë elektrike, 12.80 evro për ujë dhe pijshëm dhe 5 evro për mjedisin. Ky është fati i veteranit dhe invalidit të UÇK-ës. Qeveria e Kosovës nuk do t'ia dijë asnjërit këtë sakrificë duke na lënë në mëshirën e fatit, apo të ndihmës që dikush, si rasti i Samil Lustakut, në vitin 2009, na jep në këtë gjendje të braktisur, të shpërfillur, të mjeruar. Por mjerimi ynë nuk ka të sosur, vazhdon gjithë indinjim të ligjshëm Hasani: "Këtij mjerimi po i shërben edhe sjellja korruptive e vet kryetarit të shoqatës sonë, i cili pasi ka hedhur në plehra, në Matiqan, kartelat tona ka shënuar veteranë të rremë, kundrejt 3000-5000 evro shpërbllim për një kartë veterani. Pra në injorim të plotë të të drejtave tona të ligjshme. Edhe mediat tona, përjashtuar RTK/21, nuk kanë ngritur zërin ndaj kësaj situatë të pafalshme. Kështu, siç shprehet, më 7 mars 2018, Radio- Sharri, Dragash: "Arti i burrneshës nga Tirana, nuse Drenice, të cilën dashuria për Hasanin e çoi në Drenicë, kurse dashuria për Kosovën e lirë e rrjeshtoi pranë Brigadës 154 të UÇK-ës, në frontin e luftës për Çlirimin e Kosovës", megjithatë, nëse Kosova e lirë, qeveritarët dhe institucionet e saj, mjerisht, po bëjnë veshin shurdh e syrin qorr përballë fatit të mjerë të këtij çifti të dashuruar sa pas njëri-tjetrit, po aq pas lirisë së Kosovës, Valentina nuk harron të pohojë me dhimbje: "Jam bija e dikujt, jam motra

e dikujt, jam nëna e dikujt, por mbi të gjitha i përkas Atdheut". Me këtë gjuhë atdhetareje dhe artisteje, gjuhë shpirti dhe dinjiteti, ka pozuar fotografinë e saj unike, Valentina Haliti, e veshur gjysmë zonjë e gjysme ushtarake për t'i nderuar të gjitha femrat që kishin guximin të vishnin uniformën e UÇK-ës. Valentina tashmë nuse në Skenderaj, siç kishte ndarë fatin e jetës me drenicarin Hasan Began Haliti, po ashtu do të ndante edhe fatin e vet me luftën për çlirimin e Kosovës. Vërtet Shqipëria sot, e në veçanti Kosova, janë në ditët më të vlerësuar historikisht, koniunkturalisht, falë mbështetjes së jashtëzakonshme të SHBA-ës, si aleatit ynë strategjik, por askush nuk mund të jetë garant i përjetshëm i kësaj koniunkte, nëse brenda vetes nuk ndiejmë dhe nuk zhvillojmë përgjegjësit tona si komb, ku kreun e vendit e meritojnë luftëtarët, pjesë e panteonit të lirisë. Të tillë luftëtarë e luftëtare mbështet dhe nderon gjithë njerëzimi, çdo shtet demokratik në botë. Kushtëzimi me dorëheqje, nëse nuk do të miratohej formimi i Ushtrisë së Kosovës më është dukur hapi më dinjitoz në jetën politike të Hashim Thaçit, si Presidenti aktual i Kosovës, ish-Komandanti i UÇK-ës, pas aktit historik të firmosjes përballë hezimit të serbëve, në Rambuje, në pranverën e 1999-tës. Por kurrësi, tek ky politikan progresist, nuk mund ta kuptoj seriozitetin e këtij hapi me indiferencën institucionale ndaj fatit tejet të vështirë të ish-luftëtarëve të UÇK-ës që ai udhëhoqi, si rasti i çiftit Haliti i cili tashmë i takon Panteonit të luftëtarëve për Kosovën e lirë, pa kontributin e të cilëve, pavarësisht kontributit të shkëlqyer të Natos dhe SHBA-ës, Kosova e lirë do të mbetej përsëri një ëndërr e hidhur në memorjen tonë kombëtare. Kush gabon të gjykojë ndryshe, pëshlyen nga vetvetja, injoron autoritetin tragjik të historisë së popujve të vegjël si yni, "fatet e të cilëve, -siç shprehej diplomati i urtë, Babai i Pavarësisë dhe Shtetit shqiptar, Ismajl Qemali, - dalin nga dyert e tragjedit të mëdha". Fuqia dhe legjitimiteti i progresit tonë demokratik si komb, nuk mund të jete ndryshe vetëm si respektim dhe maksimalizim i vlerave tona si komb apo si popull, kurse injorimi apo shpërfillja e tyre, sado vonë, s'mund të jetë tjetër vetëm injorim dhe maksimalizimi i shanseve të humbura të së ardhmes tonë. Nuk besoj se ka shtet serioz në botë, që të mos nderojë panteonin e lirisë, pavarësisht se jetojmë posthistorinë, epokën e deheroizmit. Amerikanët, bie fjala, i konsiderojnë, heronj të SHBA-ës, të rënë në luftën e Vietnamit në vitet 70-të të shek. XX. Të përjetosh shpërfilljeje, të tilla, në dekadën e parë të Pavarësisë së Kosovës ndaj ish-luftëtarëve të UÇK-ës, aleate e shkëlqyer e Natos dhe SHBA-ës, në shkatërrimin e njëres prej diktaturave më gjakatare në Evropë, në fund të shek. 20-të, shpërfillje të këtij lloji duke sakrifkuar, krahas gjakut të derdhur, deri ardhmërinë e një jete normale në liri, si njeri apo familje, si rasti i çiftit Haliti, personalisht e konsideroj rendje e verbër pas kulpragmatizmit, kurse ajo më e dhimbshmja, fyerje të dinjitetit tonë si komb, ndryshe shpërfillja si mallkim i vetvetes.

**Kadri Ujkaj,**  
**Malësi e Madhe kritik letrare**

# “VDIQE” O MUÇO... TË RROFSHIN BIJTË E BIJAT!

REAGIM SATIRIK, nga Lazer Kodra

Kur morëm vesh të “vdekjen” tënde, o Muço Kristali, edhe gjaku i zemrës na u ngri! Besoje!-Për Zotin “Po”! E si mos të na ngrihet gjaku o Muço Kristali, pasi dhimbja për Ju pllakosi jo vetëm familjen tënde, të afërmit, shokët e shoqet, por edhe një ‘familje’ të madhe ‘studentesh e studentësh’ që pollën nga duart e mendjet e grupit tënd të “artë” përgjatë viteve që mbretëroje si një Aleksandër i Madh, Pirro apo Luigji i XV-të! A të kujtohet o Muço Kristali, plaku i urtë i Antikitetit me emrin Akadem, i cili për të sjell EDENIN në tokë e fali tokën e tij për të ndërtuar një shkollë. Lavdia e tij shkoi aq lart saqë sot tempulli më i lartë i arsimit quhet AKADEMI, vetëm e vetëm falë emrit të tij dhe vetëdijes së lartë se shoqëria emancipon falë arsimit të njerëzve. Sot, unë nga posti i “lartë” që kam propozoj që për “kontributin tënd të vyer” termi AKADEMI këtu në Shqipërinë tone të ëndërruar të zëvendësohet me termin MUÇODEMI! Të garantoj, se po u miratua propozimi im do të rrëmbesh qindra duartrokitje. I rrëmben, sepse në vendin tim, injoranca dhe duartrokitjet flasin shpesh...aq shpesh sa ç’shkojmë në banja! Ti vdiqe o Muço Kristali përpara se të vdisnin “vëllezërit” tuaj si Argenti, Vitrina, e disa të tjerë që mjerisht nuk po ua di emrat, pasi toka jonë ka një “mitër” pjellore të pa parë në këtë fushë të “diturisë së gjerë!”. Vdekja jote është tragjike o Muço Kristali, pasi Ju ishit një

“shkencëtar” i vërtetë edhe në fushën gjenetike të antropologjisë njerëzore: I transferove idetë dhe dituritë nga foleza normale e trurit në folezën monetare të kuletës! Bravo të qoftë o miku ynë Muço Kristali! Parajsë e Xhenet pastë shpirti yt fin! Tek Ju u falën ministra e kryeministra. U shkolluan, u diplomuan, mbrojtën tituj shkencorë, madje edhe Doktoratura e çfarë të duash tjetër! “Moralin tënd e humanizmin tënd” nuk e pati askush. As humanistët e vjetër, as Filobibliket, as Bejtexhinjtë, as Rilindasit e Naim Frashërit, as periudha e Pavarsisë e ... e askush tjetër! Tek Ju u falën edhe kryqalinjtë edhe gjysmëhanat më tepër se sa tek Krishti apo Muhamedi! Sisat tua të plleshme “ushqyen” jo vetëm mendjet “e ndritura” që ka ky vend, por edhe përtej kufinjve atërorë. A të kujtohet o i ndjeri Muço Kristali shërbimi i vyer që i bëre liderit suprem të Lega-Nordit, Umberto Bosi, për nevojën që kishte për të birin!? Ndoshta të kujtohet! Prandaj kontributi yt është kaq “madhështor”, saqë shtrihet që nga i biri i Umberto Bosit deri tek tasi yn i kosit! E “bekuar” qoftë toka që pjellë humanistë të tillë! Por, ti nuk ke vdekur o Muço Kristali! Ti ke lënë një “familje” të madhe prej gjashtëmbëdhjetë mijë pjestarësh, me diplomat tuaja në duar. Kaq diploma do të ishin të mjaftueshme për të ndërtuar Amerikën “E shkatërruar”, Gjermaninë “E rrenuar” apo Anglinë “E mjeruar”! Por fati qendron në anën tonë, o Muço Kristali! Këto mendje “të ndritura” i kemi këtu në Shqipërinë tonë të

dashur. Këto mendje i kanë dhënë Asaj “Dinjitet, prosperitet, ekuilibër, zhvillim, demokraci e çfarë të duash tjetër!”. Ne, që morëm krahë nga puplat (lesh) i nënsqetullës tënde, sot jemi kudo. Përjetësojmë Ty edhe me ministra në ministri, edhe me deputet në parlament, edhe me kryetar bashkish, edhe në drejtim, edhe në shëndetësi edhe në arsim. Fryma Juaj ndjehet kudo, prandaj edhe ky vend ka ecur “përpara”! Ti je i shkrirë dhe i ngjizur në çdo gjë të këtij vndi, ashtu si besimi Panteist i Naimit për Zotin. Zoti na ruajtë se sa gjatë do të jetojë fytyra, ngjyra, aroma, cicmici, e “humanizmi” yt në këtë vend! Të qofshim borxhlinjë përjetë! Ti, që na ngjite në “Piedestale” do të rrosh përjetë në zemrat tona. Ju ftoj për një minutë “Zi kombëtare!”. I përjetshëm kujtimi i Tij! **MINISTRIA, d.v.**

**SHENIM;** Për të ilustruar këtë reagim satirik, sot me datën 7 mars 2018, në ditën e mesuesit, po postoj një fragment nga poezia e At’ Gjergj Fishtës, me titull: **NAKFOMONICIPEDIJA.**

Kjo është një poezi plot humor e satirë (që thumbonte shqiptarët trutharë e të pakulturuar) me rastin e botimit nga Dom Ndoc Nikaj (Pseudonimi i tij **NAKDO MONICI**) të librit “Histori e Shqypnisë”. Në këtë poezi, Fishta e lavdëron së tepërmi autorin Nikaj, por duket sikur i thotë: A e din për kë ke shkruar!?

**NAKFOMONICIPEDIJA**  
*Ti me gjasë, Nakdo Monici*

*S`din si ecën n`ketë jetë “cicmici”,  
Qysh se ty mund ta haja palla  
Se po kape m`breg me prralla:  
Due me thanë, tue vu mbi letra  
Se ç`ka ndodhë ndër kohë të vjetra,  
Kinse (gjoja) t`njohë fara e Shqiptarvet  
Si pat këne besa e të parvet!  
Eh! Zotni, t`ngjatët Zoti jetën!  
Pa shikoe `i herë kuletën  
E ajo ty ka me t`kallzue,  
Se shka t`zit ke fitue  
Me njat t`bukrën histori  
Qi ke shkruar për Shqypni:  
Asë (gjen), idhnm pa fe nevoje,  
E ndo borxh edhe shtypshkroje?...  
Sod n`Shqypni, more lum miku;  
Histori asht meteliku;  
Pse për tjetër për kët besë,  
Veçse i qet ti za vall kresë,  
Veçse i lanë ti krye t`gomarit,  
Tu mundue për fis t`Shqyptarit,  
Pas Shqyptarët, si jen` tue pa,  
Sod me sod s`janë tue pas nga (ngë, kohë)  
Me u hutue me shkrimet tona  
T`cillat s`pjellin napoljona,  
As nuk bahen besa, shkallë  
Për me u njitë ku bahet pallë:  
Punë qi lypen sod ndër ne,  
Për me u rrekun për atdhe.  
Ktu` zotni, t`ngjatët Zoti jetën!  
Për pa e luejt pak gja kuletën,  
S`çilet shteg as bahet rangë (prokopi)  
Pse e kanë xanë shqyptarët atë kangë:  
“Haja qenit-pija qenit  
Edhe bjer Kara dyzenit!...”*

## Imzot Robert Ashta, ipeshkëv i dioqezës se Pultit, ne përvjetorin e vdekjes

Imzot Robert Ashta, ipeshkëv i dioqezës se Pultit, ne 20 vjetorin e vdekjes. Ishte e diela e Pashkëve te Ngjalljes, 12 prill 1998, rrethe orës 3 pasdites, kur ndërroj jete Ipeshkvi i Pultit Robert Ashta. Pasi ka mbaruar meshën e shenjte ne kishën e Shën Gjonit ne fshatin Kisha te Dushmanit ne prani te një numri te madhe besimtarësh te ardhur nga gjithë lugina e Kasketës se Drinit nga Temal-Dushmani, Toplana, Berisha, Qelëza, e deri nga Iballa e Pukës, ku ende popullsia nuk e kishte migruar ne zonat urbane. Ipeshkvi pasi ka dhënë bekimin e banoreve eshte njoftuar se ne fshatin Kllogjen te Dushmanit një i sëmure ka nevojë për sakramene. Udhëtonte kështu ne mushke ne një rrugë te vështire, ku sapo ka hyre ne fshatë jep shpirte ne fshatin Kllogjen ne Dushman. Udhëtonte kështu mbi mushke, drejte cakut te fundit te jetës se vet. Po ne te njëjtin vende para 390 vjetësh këtu ne Dushman vdes edhe Imzot Pjeter Budi një nder shkrimtaret e pare te gjuhës shqipe. Askush me shume se Imzot Robert Ashta nuk i përngjau paraardhësit te tij për te dërguar fjalën e Krishtit nder malësore. Burrat e Dushmanit duke ju prirë kryeplaku Kol Shkoza me nderime te mëdha e përcjellin ipeshkvin e tyre ne vige nga fshati Kllogjen për ne Kisha Arre, pastaj me varke e makine drejte banesës se tij ne Kuvendin e fretërve, ku kishte nisur dhe jetën e formimit te tij.

Imzot Robert Ashta lindi ne Shkodër me 22 gushte 1918. Shkollën fillore e te mesme i kreu pranë kuvendit te Shën Franceskut ne Gjuhadole, Shkodër. Veshi zhgunin e fretërve te vegjël me 13 korrik 1934 ne Troshan, ku kreu dhe vitin e novaciatit. Pas kushteve te përkohshme, me 24 gusht 1935, vijoj studimet ne Shkodër. Me 23 gushte 1939 beri kushte e përjetshme ne famullin e Thethit. Nga viti 1939 deri me 1944 vijon studime filozofike e teologjike ne Siene e vijon dhe i kreu ne Motta di Levenza Trevizo Itali. Me 1941 mori urdhrin e diakonatit ne Venedik, për tu shuguruar me pas meshtar ne shenjtoeren Zoja e Mrekullive te Motto di Leven-ces, Triveso. U kthye menjëherë ne Shqipëri dhe nisi shërbimin meshtarak ne famullit e Dukagjinit e te Mirditës, me 1944-1946 shërbeu ne Curraj te Epërme e ne Baz-Bushkashe te Lurës. Gjate kësaj kohe ishte dhe profesor i matematikes ne Liceun françeskan Ilyricum. U detyrua te ndërpres shërbimin meshtarak ku regjimi komuniste e thirri nga altari për te kryer shërbimin ushtarak. I deshe te rrokte armët qe deri atëherë nuk e kishte prekur kurrë me dore. Pas detyrimit ushtarak u kthe ne Lure ku shërbeu nga 1950 - 1955. Nga ky vite deri ne 1967 shërbeu ne famullin e Vuklit e Selce. Eshte viti qe ne vendin tone u mbylleen te gjitha kishat. Ka jetuar ne familjen e vete duke punuar si punëtor krahu ne komunale e ne vitin 1974- deri me 1985 do te punoj ne veprat e dritës ne Vaut-Dejës e Komanit.

Kame pasur fatin te njihesha për afër pasi ne mbarim te vitit te pare te shkollës se mesme ne 1979 te punoj ne brigadën e ujësjellësit te Benës ku nxënësit e shkollave ndihmoheshin nga shteti për te siguruar pak te ardhura për veshje. Ne ketë brigade punonte baba ime e shume burra te tjerë nga gjithë vendi dhe mua me caktojnë ne brigadën e Baftjar Merit, një shkodoran me kulture e i qete. Detyra ime ishte qe punëtoreve te brigadës ti furnizoja me ujë. Baba im, Kol Zefi si fëmijë qe isha krahas te tjerëve, me këshilloj qe te ose harroj as Cesk Ashtën, ku me shpjegojë se ka kenë priftë. Kështu u njoha me ketë punëtor qe mbante kominoshe e çizme dhe një këmishe te bardhe. Çdo dite bënte dy ore ne këmbë nga zona “A” ne Koman e tek kanali qe po hapej për te sjelle ujin e Benës ne Koman. Jetonte ne një barake dërrasash dhe kishte modifikuar disa pantofla prej dërrase me llastike për te shkuar nga banesa

për tek duset qe ishin te përbashkët për te gjithë punëtoret. Shume dite ngarkohej me detyre për te lexuar shtypin e ditës para fillimit te punës, ku çdo brigat 15 minuta para pune lexonte gazetën “Zëri i Popullit”. Rrinte ne vetmi te plote dhe fliste tepër rralle. Banesa ku jetonte ishte afër Kishës se Shën Markut ne Koman ku ne atë periudhe ishte kthyer ne një mulli bloje për kooperativen. Dua te cilësoj se edhe pse feja ishte e ndaluar shume njerëz ju drejtoheshin ne fshehtësi për me treguar ditët e festave fetare. Me 1990, kur prifti Dom Simon Jubani Kremtoje meshën e pare pas regjimit komunist At’ Robert Ashta ndodhej pranë altarit te Kapelës për te vazhduar meshën pas çdo te pa pritire qe munde te ndodhte gati për te vijuar kremtimin. Me 18 nëntor 1990 kremton meshën e pare publike ne Bajze, qe nga 10 janari 1992 shërbeu si famullitar ne Laç, duke zgjeruar shërbimin edhe ne Rubik, Baz-Bushkash e Lure. Pikërisht ne ketë stine te vonë te jetës, kur kishte mbushur 75 vjeç, françeskani At Robert Ashta u thirre për detyrën e rëndësishme te Ipeshkvi. Ishte vete Papa Gjon Pali i II qe gjate vizitës se tij ne Shqipëri me 25 prill1993, e shuguroi ne Katedralen e Shkodrës Ipeshkëv i Dioqezës se Pultit. E imzot Robert Ashta, ndonëse tashmë perlat vijonte ti ngjitej maleve te thepisua, here ne këmbë e here ne mushke me kryqin e madhe te ipeshkvi i fshehur pak nder palat e zhgunit.

Gjate gjithë kohës ne detyrën e Ipeshkvi beri gjitha përpjekjet qe te ngrihen Kishat ne Dukagjin qe ishin shkatërruar nga regjimi komuniste, me një pune te palodhur, përveç ndërtimit te veprave te kultit, punoj për kultivimin e besimit ne masën e malësorëve, ku duhet te përmendim përgatitja e një Liberi për katekizmin dhe botime te tjera te besimit. E pikërisht atje ne shtigjet e vështira te Dushmanit Krishti e thirri nga Pashkët tokësore, ne Pashkët pa mbarim te Mbretërisë Qiellore. Ishte 12 prilli 1998, e diela e Ngjalljes.

Edhe pse kane kaluar 20 vite ende për banoret e maleve te Dukagjinit ruhet ne kujtesë përkushtimi i këtij prelati i cili me çdo kusht beri përpjekje qe kisha te funksionoi edhe ne periferi. Aty ku ne vuajtje te tejskajshme kurrë nuk e humben besimin ne fenë katolike, qe te paret tanë për te ruajtur fenë jetuan ne male, te cilat Perandoria Osmane nuk mundi kurrë ti pushtojë.

**Zef Nika, Bruksel**

## Shkodra: Masked terrorists attack to kill an expatriate

Yesterday in the northern city, during the day, around 10:30 AM in the middle of the city, in front of the Cathedral of Shkodra, three masked men have terrorized the civilians and physically violated an expatriate who had returned from America only one day before the event. He was barbarously violated, as much as there was bloodiness, the expatriate Vitor Pukri. Witnesses, who are afraid to identify themselves for the newspaper, say the three masked men had the intention to kill the victim, but two random persons stopped their car and got physically in conflict with the perpetrators to protect the expatriate's life and have managed to take the bloody knocked-out victim and put him in their car, fleeing quickly and without an address. The two people, whose identities we do not know, saved his live, but it is not known where they



sent expatriate Pukri.

Through sources at the police, it is

learned that Vitor Pukri had about 17 years not living in Albania, because his life was endangered by mafia groups with Islamist terrorist backgrounds, which long time ago have introduced him in the red circle to kill him.

It is also learned that Pukri does not have any relatives in Albania and that a few minutes before the criminal event he had requested the help of the Police Commissariat of Shkodra to provide him identity documents to go to Italy to his relatives. So, as soon as he got out from the Police Commissariat, the three masked men shot and tried to kill him. It looks like from within the police, the terrorist group has been notified to wait and physically eliminate the expatriate Vitor Pukri. And State Police is the most criminal sector in recent years, where even former Interior Minister Saimir Tahiri is accused of being the boss of drug mafia, and

he is openly being defended by the Prime Minister Edi Rama, accused of corruption and close connections with the drug mafia and Islamic terrorist groups. A study by the Institute for Democracy and Mediation, supported by the Dutch Foreign Ministry, found that Albanian police are the most corrupted institution in the country.

Crime in Albania today controls all sectors of life, from the simplest police to the judiciary, MPs, ministers, and the accusations are very serious even for the Prime Minister and the President of the Republic. Also yesterday, US Ambassador, in Tirana, Donald Lu, has made a strong statement, saying that state leaders have trafficked human beings and that criminals with power should be arrested as soon as possible.

The Editorial Office

## EULEX zbarkon në Aeroportin e Prishtinës, 6 turqit e arrestuar nuk gjënden në Kosovë

Mediat në Prishtinë vazhdojnë të raportojnë për çështjen e 6 shtetasve turq të arrestuar një ditë më parë. Gazeta Express shkruan se sonte në mbrëmje policia e EULEX ka kryer kontrolle na Aeroportin 'Adem Jashari' për të parë nëse ishin deportuar apo jo shtetasit turq. Pas kontrollit të oficerëve të EULEX, ka rezultuar se turqit e arrestuar nuk ndodhen në zyrat e Aeroportit të Prishtinës. Ndërkohë më herët gjatë ditës një prej familjarëve të të arrestuarve i tha Express se të arrestuarit ndodhen në aeroport.

"Turqit e arrestuar nga Policia nuk janë deportuar nga Kosova. Ata janë duke qëndruar të ngujuar në Aeroportin e Prishtinës dhe në Ambasadën e Turqisë. Unë gjatë ditës së sotme tre nga ta i kam parë në një zyre në Aeroport. Sot atyre u kanë shkuar ekipe mjekësore për t'i kontrolluar", ka treguar njëri nga familjarët e të arrestuarve.

Të arrestuarit janë identifikuar si Cihan Özkan, Kahraman Demirez, Hasan Hüseyin Günakan, Mustafa Erdem, Osman Karakaya dhe Yusuf Karabina. Ata janë arrestuar si të dyshuar për lidhje me klerikun Fetullah Gylen, i cili konsiderohet si një nga kundërshtarët më të mëdhenj të presidentit turk Erdogan.

Redaksia e Gazetës



# GJELOSH LULASHI, ANTIKOMUNISTI MARTIR I KISHËS KATOLIKE

## ME RASTNË 72-VJETORIT TË PUSHKATIMIT

Në 'Parajsen' e shpirtërave të martirëve antikomunistë, besoj se shpirti i Gjelosh Lulashit është sythi apo lulja në çelje e sipër, cicërima fluturuese e zogjve shtegtarë, që lajmërojnë stinën e Pranverës, stinë të cilën toka e vendit tim e ka veshur rrallëherë përgjatë historisë.

Gjelosh Lulashi lindi në fshatin Ndreaj, të krahinës së Shoshit, me 2 shtator 1925 i biri i Mires dhe Lulash Gjeloshit. Ka shumë pak të dhëna, të shkruara, për rininë e tij, por imazhet e fiksuara në kujtesën e bashkëmoshatarëve të tij (tashmë të pakët në numër) i japin atij gjithë hirit apolloniane të një malësori dukagjinas përfaqësues i tipologjisë fine të të riut të kësaj krahine. Ishte ndër ata pak të rinjë dukagjinas që pati fatin që të fillonte studimet në Kolegjin Saverian Shkodër në vitin 1936. Jak Palushi, vëllai i penelstit të njohur Tefë Palushi shprehet "Me Gjeloshin jam takuar tek Kuvendi I Jezuitëve. Ai aty studionte, kurse unë isha në "shoqërinë e Kryqtarëve", aty jemi takuar dhe njohur bashkë. Gjeloshi ishte një djalë i pashëm, i zgjuar dhe serioz, njeri me temperament të fortë, por edhe i qeshur dhe i ngrohtë". Pas

perfundimit të shkollës, në vitin 1942 shpresonte t'i jepej e drejta e studimit në Akademinë Ushtarake të Romës. Situata e turbullt politike nuk e favorizoi një gjë të tillë, ndaj filloi punë si kancelar në spitalin civil Shkodër. Në kohën e okupacionit rreshtohet në anën e "Ballit Kombëtar" i rekrutuar, me dëshirën e tij, nga Kapiten Mark Mala, me të cilin ishte njohur që nga viti 1942 gjatë pushimeve në Theth. Ishte një kundështar i vendosur i udhëheqjes së PKSH. "Në bazë të kësaj miqësie që krijova aty, Mark Mala, kur po ngrihej batalioni i Dodë Nikollit me 1943, më thirri dhe më mbushi mendjen të marr pjesë në të..., me veti kam pasë edhe 13 dukagjinas që u mobilizuan në Shosh. Këta i kisha marrë me konditë që me ndejtë në Shkodër dhe mbasi ikem në Elbasan, 6 prej tyre më dezertuen".

"Gjelosh Lulashit nuk iu ndanë për asnjë çast Marash Pjeter Kulla (Ndreaj), Prekë Ujk Ara (Mekshaj) e Mëhill Kokrri (Palaj)". Pas nisjes së batalionit për në Elbasan, Gjeloshi, si krahu i djathtë i Major Dodë Nikollit, merr gradën N/toger. Pas Elbasanit, batalioni nis për Vlorë, ku Gjelosh Lulashi me një pjesë të grupit vendoset në Drashovicë. Në konfrontimin e Batalionit që drejtohej nga Dodë Nikollit dhe Brigadës së Parë Sulmuese të komanduar nga Mehmet Shehu pati një rezultat disfatist Major Dodë Nikollit, ç'ka çoi në shpërbërjen e këtij batalioni dhe 'çmendurinë' e Dodë Nikollit". Pas këtij zhgënjimi të madh dhe konfliktit që kishte shperthyer mes ballistëve dhe partizanëve, Gjeloshi kthehet pran vendlindjes së tij. "Në prag të çlirimit, Komandanti i rrethit të Dukagjinit, Lekë Vojvoda, i beson detyrën e Z/Komandantit të rrethit, detyrë të cilën e kreu deri sa shpertheu konflikti i aramatorur mes forcave nacionaliste dhe UNC në qafën e Kolçit". Në këtë konflikt, Gjeloshi si antikomunist i betuar mban krahun e forcave nacionaliste, ku Komandant i përgjithshëm i Qarkut të Shkodrës ishte Mark Gjon Markaj, i cili i vë në dispozicion 120 xhandarë për t'i shkuar në ndihmë Mark Malës, Gjergj Vatës, Pjetër Mehmetit dhe Mark Tunxhit me shokë, por që nuk arritën të mbërrinin atje për arsye se forcat nacionaliste pësu-



an disfatë. "Gjithsesi Gjelosh Lulashi, Gjergj Vata, Ndue Pali dhe pasuesit e tyre, me kokëfortësi, deshën të ndiqnin shembullin e Qafës së Kolçit edhe në Kodër-Shëngjergjit kundër forcave partizane të Brigadës VI e XXVS. Ka qënë nderhyrja e zgjuar e babait të tij, Lulashit, që shmangu një konflikt të pabereqet me pasoja të paparashikuara". Pas fitores së komunisteve dhe vndosjes së hegjemonisë së plote pushtetare, Gjeloshi arratiset në Malet e Shoshit. "Në mal ndejtëm me baben për tre muaj, pastaj vendosëm me u dorëzue dhe i derguem fjalë kushëritit të Kolë Prelës për të ba marrveshje". Në atë kohë Gjelosh Lulashi, Mark Sadiku, Kolë Ndou, Sadik Marku, Lulash Gjeloshi, Nikë Gjeloshi, Sokol Bala, Mark Vuksani e shumë dukagjinas të tjerë të arratisur në mal ndodheshin në bjeshkët e Pepsujmajeve (Mbasbraniku). Lulash Sokoli i Pepsujmajeve ishte njeriu që me porosi të Profesor Kolë Prelës takohet me Lulash Gjeloshin, Mark Sadikun dhe Kolë Nduen, të cilëve u tha: Vije me porosi të Kolë Prelës. Ai më ka thanë, hajdeni e dorëzoni tek unë, pasi kam hy dorëzanë tek Mehmet Shehu. Ju nuk i keni la duert me gjak e sa për daljen në arrati në mal është një gabim që falet. "Ata kan ardhë me mue dhe pasi kanë hager mjesditë në Pepsujmaj (tek shpija e Lulashit), pasdite shkuan në Kodër-Shëngjergjit, u takuan me Kolë Prelën dhe mbasanej kan shkue të lirë në shtepitë e tyre". Ky rrefim i Lulash Sokolit të Pepsujmajeve, 45 vjet pas ngjarjes, përputhet tërësisht me deklaratimet e Gjelosh Lulashit në hetuesi ku thuhet: "Erdhëm mbasanej, Prof. Kolë Prela me ndermjetësinë e të cilit shkua dhe u paraqitem tek Major Ndreko Rino, ku prej andej na derguan të lirë në Shkodër dhe baba me bajraktarin e Shalës shkua në Tiranë dhe u takuan me Komandantin e Përgjithshëm Enver Hoxha". Urrejta ndaj komunizmit ishte e ngulitur në vetëdijen e Gjeloshit. Ajo kishte depertuar deri në palcën e eshtrave të tij, deri në qelizën e fundme të trupit të tij. Ndaj në këto kushte nuk kishte se si të ekzistonte asnjë lloj paqeje shpirtërore midis antikomunistit Gjelosh Lulashi dhe regjimit që shtrinte çdo ditë e më tepër falangat e krimin dhe tetakulat oktapodiane të shperfytyrimit

njerëzor. Edhe pse kishte filluar punë pran Spitalit Civil në Shkodër, mendonte e vëpronte pareshtur kundër regjimit. Gjelosh Lulashi, që nga nëntori i vitit 1945 ishte një ndër antarët më të vjetër të organizatës "Bashkimi Demokristian Shqiptar". Qëllimi i kësaj organizate ishte: Përmbyjsja me çdo kusht i regjimit komunist në Shqipëri. Veprimtaria e kësaj organizate zhvillohej ilegalisht dhe në bashkëpunim të ngushtë me mendjet më të ndritura klerikale të kohës si Danjel Dajani, Pader Xhovani Fausti, Xhakue Mark Çuni dhe me antikomunistët e betuar Qerim Sadiku, Major Gjelosh Luli dhe kushëririn e vet Pjeter Delia. "Pjetër Delinë e kam kushëri, këtë e mora me vete qysh natën që shkova në mbledhjen e grupit dhe për pakënaqësitë tona kemi pasë bisedue edhe më përpara". E gjithë veprimtaria e kësaj organizate dirigjohet nga mesuesi i ndërgjegjës kombëtare, Pater Gjon Shllaku. Gjelosh Lulashi arrestohet me 13 dhjetor 1945, ndaj të cilit Prokuroria Ushtarake e Rrethit Shkodër përpilon Akt-Akuzën 9/14, Shkodër me 29. 01. 1946 me përmbajtjen si vijon:

1. Ka qënë antar aktiv i organizatës "Bashkimi Shqiptar" ka luajtur rol me rëndësi në propagandë dhe veprime të tjera, sidomos në ushtri.

2. Ka shpërnda trakte në ushtri

3. Ka propozue në mbledhje të ndryshme të organizatës krijimin e dorës së zezë, për të fillue atentatet kundër njerëzve të pushtetit.

4. Ka qënë armik i pushtetit popullor, qysh në fillim ka bërë pjesë në formacionet mercenare të krijuara nga oupatorët ku ka pasë gradën N/toger.

5. Veprat e të pandehurit vërtetohen qoftë nga pohimet e të pandehurit si dhe atribumet e të pandehurve të tjerë.

Veprimtaria e tij parashikohet prej nenit 15 të Ligjës mbi Organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Ushtarake dhe neni 1 të Ligjës nr. 21, Mbi Sabotatorët e Pushtetit.

PROKURORI I GJYQIT USHTARAK, KAPITEN ARANIT ÇELA.

Ka pasur shumë diskutime nëse kjo organizatë ka ekzistuar në të vertetë apo jo? Po ekzistenca e kësaj organizate është e vërtetuar plotësisht nga dokumentet arkivore dhe deponimet në hetuesi nga Gjelosh Lulashi dhe pjestarët e tjerë të kësaj organizate. E vërteta është se kjo organizatë veprroi në dy fronte; nëpërmes nxitjes së kryengritjeve në terren duke besuar në një zbarkim të mundshëm Anglo-amerikan dhe nga ana tjetër duke tentuar për krijimin e një grupi deputetesh në kuvendin e dalë nga zgjedhjet e vitit 1945. Në luftën politike u përfshi edhe deputeti, Profesor Kolë Prela, i cili mbajti lidhje të ngushta dhe aktive me Pater Gjon Shllakun, Gjelosh Lulashin e Bashkimin Demokristian deri në fundin tragjik të tij. "Gjelosh Lulashi përfundoi në burg, si të gjithë antarët e tjerë të kësaj lëvizje, gjithsesi në mënyrë të paepur kaloi në tortura të rënda për disa muaj rresht. Seanca e XVII-të e Gjykatës Ushtarake Shkodër, e çelur në orën 9. 00 të datës 22. 2. 1946 shqyrtoi vendimin përfundimtar kundër elementëve udhëheqës të organizatës fashiste "Bashkimi Shqiptar". Në orën 11. 00, kryetari i Gjykatës Ushtarake, Toger Mustafa Iliazi vuri në dukje 'fajësinë' dhe mbështetur mbi nenet përkatëse ndeshkimin e tyre.

"ME VDEKJE: Pader Xhovani Fausti, Pader Danjelo Dajani, Pader Gjon Shllaku, Gjelosh Lulashi, Mark

Çuni, Qerim Sadiku, Gjergj Bici, Franco Mirakaj.

ME BURG TË PËRJETSHËM:

Gjelosh Luli, Pjeter Berisha, Ndoc Vata, Gjon Shllaku, Preng Zezaj e Zef Mirdita.

ME 30 VITE BURG: Gjovalin Zezaj, Mark Lulashi, Mark Shllaku, Nino Kurti, Andero Petroviç dhe Pjeter Delija.

ME 20 VITE BURG: Luigj Shoshi e Paulin Pali".

Pas këtij vendimi u bë edhe njoftimi i Tiranës zyrtare, nga e cila pritej miratimi përfundimtar i këtij vendimi. Përgjigjia për Gjykatën e Shkodrës mbërriti me shkresën nr. 65, dt. 26. 2. 1946. I vetmi ndryshim ishte se ndeshkimi me vdekje i Gjergj Bicit kalon në burgim të përjetshëm. Ky vendim ishte i firmosur nga vetë Enver Hoxha në cilësinë e Ministrit të luftës dhe Mbrojtjes Kombëtare. Jo vetem në hetuesi, por edhe në momentin e komunikimit të denimit me vdekje, Gjelosh Lulashi qendroi si i ka hije një idealisti me karakter të pathyeshëm, që përballë ideve e vendosmërisë së tij është gati t'i bëjë sfida edhe jetës, ndonëse vetëm në moshën 21-vjeçare. Kjo dëshmohej edhe nga Proces-verbali i mbajtur mbi vullnetin e fundit: "Sot, me datën 4 mars, ditë e Hënë, ora 5 mbasdreke, unë aspirant Tonin Miloti, me cilesinë e z/prokurorit të Gjykatës Ushtarake të Shkodrës, shkova në vendin ku do të ekzekutoheshin të denuarit me vdekje për të marrë fjalën e fundit të tyre dhe për t'u ndodhur prezent në kohën e pushkatimit, të cilët pasi u pyeten para se të ekzekutoheshin thanë...

GJELOSH LULASHI: "Thoni babës të më falin se e kam trazue. Të më falin shokët se ndonjë fjalë e kam thanë prej zorit që kam pasë. Nanës të fala dhe të mi puthin vllaznit. Borxhet që kam mbetë të mi paguejnë prindët. I fali me zemër të gjithë ata që më kan ba keq. Rrnoftë Shqipnia!" Gjelosh Lulashi u ekzekutua bashkë me shokët e tij me 4 mars 1946. U ekzekutua në mënyrën më barbare të mundshme. U ekzekutua afër varrezave të Rrmajve, aty ku preheshin në qetësinë e Amshueshme qindra e mijra shpirtira njerëzorë të qytetit të Shkodrës. Ndonëse shumë afer shpirtirave e eshtrave të tyre, trupi i Tij nuk u varros kurrë brenda atyre mureve të bekuara me Vajin meshtar e të Pagëzuara me Vargun Biblik: SHPIRTI U PUSHOFTË NË PAQE! U varros në rëren e Zallit të Kirit bashkë me shokët e tij. U varros pa ledhatimin e ballit të ftohtë nga dora e së ëmës. U varros pa uratën e të atit; Të pastë Krishti në Parajsë! Varri i Tij dhe i shokëve të tij nuk dihet. Ai ishte diku në një cep të zi të tokës Shqiptare. Të kësaj Shqipërie, që historia e udhëheqësit e saj betoheshin në të, ndërsa në të vertetë bënë masakrat më të tmerrshme që ka njohur globi. Në emër të saj, turpsisht, lanë qindra e qindra bij e bija pa varre. Kjo tokë e nëpëkëmbur meriton të quhet: "Toka e njerëzve pa varre!" Gjelosh Lulashi mbetet simboli i padiskutueshëm i idealistit antikomunist, i qendrestarit të paepur, i besimtarit në Zot e Krisht dhe një ndër më të merituarit e të qenit MARTIR I KISHËS KATOLIKE!

## Referencat:

- 1-Jak Palushi, gazeta "Dukagjini", nr. 12, Gusht 2005
- 2-AMB, Dosja nr. 1068, fleta 52
- 3-Prelë Milani, libri "Shoshi", faqe 321
- 4-AMB, Dosja 1068, fleta 53
- 5-AMB, Dosja nr. 1068, fleta 53
- 6-Prelë Milani, libri "Shoshi", faqe 321
- 7-AMB, Dosja nr. 1068, fleta 54
- 8-Prelë Milani, libri "Shoshi", faqe 321
- 9-AMB, Dosja nr. 1068, fleta 54
- 10-AMB, Dosja nr. 1068, fleta 55
- 11-Prelë Milani, libri "Shoshi", faqe 323
- 12-Gazeta "Koha e re", 26. 02. 1946

Përgatitur nga LAZER KODRA

# Një nga kryeveprat ma të mëdha krijue nga njerëzimi, përsëri në gjuhën shqipe: KOMEDIA HYJNORE.

## Dy fjalë për përkthyesin

Përkthimi i ri vjen nga penda e Meritan Spahisë. Prandaj na duket e arsyeshme t'ju njohim, në fillim, me përkthyesin, i cili na krijoi një mundësi të re, për ta lexue "Komedinë" në gjuhën shqipe. I lindun në Shkodër, më 1967, vijoi Liceun artistik "Prekë Jakova", në degën e Skulpturës e u diplomue në Universitetin Luigj Gurakuqi, në degën e Gjuhë-Letërsisë. Mësues në fshatin Tamarë (1990-1991) së pari, sot anëtar i Departamentit të Gjeografisë, në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", ku, më 2014 gjithashtu mbrojti gradën Masteri Shkencor në *Studime të Thellueme në Gjuhësi*. Flet e shkruen italisht, frëngjisht e anglisht. Doemos, ma mirë se të gjitha, shqip, në të dy dialektet.

Njihet si autor tregimesh [Luleshtrydhet (2002); "Vegimet e fundit" (2016)], romanesh ["Vegimet e një dite me shi" (2004), "Alegoria e një historie të vërtetë" (2007)], e përkthimesh [pjesë të cenzurueme të romanit "Të Mjerët", të Viktor Hygo, revista "Orana"]. Së shpejti do të shohë dritën e shtypit "Ferri" i tij, por edhe përmbledhja me tregime "Monolog me vetveten" dhe rrëfimi "Enea iku i fundit".

## Komedia, thirrje e një njeriu drejtue njerëzimit


Ky, jetëshkrimi i përkthyesit, në të cilin nuk gjejmë asnjë pikë të dukshme takimi me jetën e Dantes: shtegtar i vetmuem, gjithnjë i shqetë, që bredh larg vendlindjes e edhe shuhet larg saj. Megjithatë, një shtytje tejet të fuqishme duhet ta ketë pasë përkthyesi, kur mori pendën e ia hyni një pune tepër të vështirë: përkthimit të Komedisë: sintezë e thellë e jetës, transfuzion i plotë e i përkryem i një krijese të kësaj bote në materien e amshueme të artit, vepër që e josh fuqimisht shpirtin njerëzor me shtegtue, gjithnjë në shoqni të Poetit, në tri mbretitë e përtejme. Me marrë udhën kah universaliteti i ndjenjave e ideve, viseve e lugjeve të verbta, veseve e virtyteve, sendeve të nëntokës e rretheve të qiellës, në bisedë të vazhdueshme me Zotin.

Komedia ngjall kureshtje, ankth, hap horizonte në shpirtin e njeriut që e lexon, tue kërkue e tue gjetë në të, vetveten. Sepse secili e lexon në mënyrën e vet.

Komedia asht thirrje e një njeriu, drejtue njerëzimit, botës së njohun e të panjohun, atyne që janë e që do të vijnë. Asht udhë, që të çon te caku i sigurt. Prijëse për të zbulue vetveten deri në hone e deri në kupë të qiellës. Për të zbritë në fund të shpirtit, për të hy në viset e pafundme të intelektit e në afshin e fesë - privilegj i Dantes - i cili i prin përkthyesit e, doemos edhe lexuesit, në një shtegtim personal pastrues e shembues.

## Art i pashoq

Shtegtim i realizuem me një art të fuqishëm, të pashoq në letrat europiane, me një gjuhë, që i përngjet detit pa fund, herë të qetë - e herë me valë malore, me kreshta shkumbe e me dridhje, që të përshkojnë si



korrent elektrik. Gja që krijon vështirësi gati të pakapërcyeshme për përkthyesin.

Nga tre Kantikët për bamës të Komedisë Hyjnore, "Ferri", Kantiku i parë, i kryem nga përkthyesi i ri, asht ma i njohuni e ma i lexuemi, sepse asht ma i pasuni me episode plastike e ma pranë natyrës sonë njerëzore. Pa harrue se të paraprin e të përgatit për të marrë të përpjetën kah Parrizi e për të kremtue lutjen përfundimtare:

*«Vergine Madre, figlia del tuo figlio,  
umile e alta più che creatura,  
termine fisso d'eterno consiglio,*

*tu se' colei che l'umana natura  
nobilitasti sì, che 'l suo fattore  
non disdegnò di farsì sua fattura.*

*Nanë virgjineshë, ti bija e tand bir,  
mbi çdo krijesë e prunjtë e madhështore,  
nga kshilli i amshuem cak i vendosun mirë,*

*ti je ajo, që natyrën njerëzore  
e ngrite aq, sa vetë krijuesi unji  
me u ba krijesë e saj s'e pat për kore.*

Nuk asht, prandaj, aspak e lehtë të përkthehet kjo vepër, me "stil dantesk" e karakteristika që gjermanët i quejtën "starke Verdichtung" – "Poetifikim i fuqishëm" i pashterrshëm. Aftësi për ta pa gjithçka me sytë e mendjes, që i shndërron si me magji, përmbajtje e formë - në tingull e dritë. Asnjë poet tjetër nuk ka mbërrijë në këtë naltësi, në të cilën njerëzorja shkrihet me hyjnoren. E gjithë kjo, tue përdorë një gjuhë të thjeshtë, krejt të zakonshme, fare pranë me atë që flitej: gjuhën e popullit, shumë të pasun me shprehje frazeologjike. Në dialektin toskan, e folme fiorentine e nanës, që shumë shpejt do të vehej në themel të italishtes letrare. Këtë rrugë ndjek pak a shumë edhe përkthyesi. Ndonëse tue përdorë një dialekt të mohuem, për arsye jashtëgjuhësore.

## Dante, shok udhe me lexuesin

Këtu nisin pikat e takimit të Poetit me përkthyesin e lexuesin. Dante, i huej në dhe të vet, viktimë e hakmarijeve politike, i detyruem të ravgojë larg Firences, deri në thellësitë e përtej vorrit, ka shumë të përbashkëta me një mori njerëzish, që

enden edhe sot pa gjetë paqë, në kërkim të vetvetes e të një caku të sigurt, larg pshtjellimeve të pështira të politikës, prijësit e së cilës ka për t'i gjetë shpesh ndër rrethe të Ferrit. E kemi shok udhe, pra. Ashtu si do ta kemi pranë në përpjekjen për ta vlerësue madhniën e pakrahasueshme, në qiellin e jetës shpirtnore, nëse përkthyesi i ri do ta vijojë shtegtimin mbas Dantes, deri në Kangën e fundit të Parrizit, që mbyllet me tercinën kuptimplotë:

*A l'alta fantasia qui mancò possa;  
ma già volgeva il mio disio e 'l velle,  
sì come rota ch'igualmente è mossa,*

*l'amor che move il sole e l'altre stelle.*

*Së lartës fantazi iu pre fuqija;  
dëshirën, tash, vullnetin tim vazhdueshëm  
sillte, si rrotë nën shtytje t'njajtë Dashnija,  
që lëviz diell e yj të vezullueshëm.*

## Dy fjalë për formën

Mjeti i parë, që duhej përdorë, ishte pa dyshim gjuha. E përkthyesi zgjodhi si gjuhë përkthimi një gegnishte, që tingëlton thjesht shqip, në kuptimin përgjithësues të kësaj fjale. Ashtu si vijoi të tingëllojë italisht, dialekti fiorentin i Komedisë. U përpoq, kështu, t'i përshtatet gjuhës së Dantes, tue u bazue në gjuhën e folun e amtare, me përdorim të një mori regjisttrash linguistikë, me çkujdesje, hir, harmoni e përqendrim mbi shprehjet e përditshme, me fjalë e batuta pak a shumë të rafinueme. E për të hapë edhe horizonte të reja sintaktike e leksikore, pa përjashtue format ma të gjalla, agresive e popullore.

E kjo asht edhe një prej meritave të Meritan Spahisë i cili, përveç kësaj, rrejti besnikisht edhe tercinën danteske, që nuk asht thjesht element i formës, por edhe e kryesisht, i përmbajtjes.

## Tercina danteske

Kujtojmë se përkthyesit e shumtë, që u morën me Komedinë, u ndeshën në pengesën, nganjëherë të pakapërcyeshme, të tercinës danteske. Atëherë shumë prej tyne u detyruen ta zëvendësojnë herë me katrene e herë me rrëfimin në prozë të kësaj vepre thellësisht poetike. Po tercina, e shpikun nga vetë Dante, nuk mund e as nuk duhet prekë. Nuk asht element formal, i dorës së dytë, as aspekt, që ndihmon për të përcaktue ritmin: asht vetë ritmi; madje mund të thohet – vetë Poema. Tercina kompozohet me tre endekasilabe danteske - varg njëmbëdhjetë rroksh, me thekse ritmike te rrokja e dytë, e katërt, e gjashtë, e tetë, e dhetë (2/4/6/8/10), me skemë ABA BCB CDC DED ... UVU VZV Z. Vargu i parë rimon me të tretin, i dyti, me të parin e tercinës pasuese, e kështu me radhë. Rimë zinxhir, që përfundon me një varg, i cili në metrikë njihet me emrin *quinario*, i kompozuem nga pesë rrokje. Kjo skemë krijon mundësinë që, kur një stancë apo strofë përfundon, e reja ka lindë tashma, asht aty, në rimën e ndërmjetme. E kush e lexon, me ritmin e saj jambik, ndjen rritjen

e kreshtës së valës së re, që ngrihet menjëherë mbas asaj, e cila asht përplasë tashma në breg. E çka ka ma shumë randësi, kjo formë krejt origjinale danteske - shkrihet plotësisht me idenë e Trinisë Shenjte. Nuk asht pra, kurrsesi formale. Prej saj nuk mund të hiqet dorë.

Përkthyesit të ri iu desh t'i studiojë thellësisht të gjitha këto elemente, e edhe kritikën ma moderne për vepren, gja që pasqyrohet në aparatit tejet të pasun kritik. Nuk u tremb, pra, prej gjithë këtyne valëve me kreshta të frikshme shkumbe. Mori përsipër, nismën e guximshme - ndokush mund ta quejë edhe të çmendun - me e ndihmue Danten t'i thellojë njohunitë e shqipes, që ia patën mësue, para tij, disa mjeshtra të tjerë.

E kjo don me thanë edhe me e vu përsëri gegnishten, mbasi ka përshkue të tanë rrathët e Ferrit - në krye të vendit - në sofrën e Parrizit, ku fliten të gjitha gjuhët e gjalla e të vdekuna të njerëzimit!

## A duhej përkthye rishtas Komedia?

Nuk asht hera e parë që përkthehet "Komedia". E përkthyen, pjesërisht a tanësisht Luigi Lorecchio (arbërisht), Ernest Koliqi, Martin Camaj, Mark Ndoja, Nikollë Daka, Pashko Gjeçi (përkthime të pjesshme e të plota, gegnisht) dhe Çezar Kurtin (Ferri, përkthim në gjuhën zyrtare). Prej këndeje, ndokush mund të mendojë se nuk ishte aspak e nevojshme të përkthehej përsëri. Po përvoja e përkthimit na ban me mendue ndryshe!

Së pari, duhet pasë mirë parasysh se përkthimi asht shkencë e, sidomos, art. Mund të realizohet në mënyra të larmishme, tue nisë nga përkthimi interpretues, besnik ndaj ideve, ndjenjave e stilit të autorit, te përkthimi i lirë. E, së dyti, edhe se nuk mjafton të dish gjuhë të hueja, për të sulmue maje kaq të nalta, si kryeveprat botnore në të gjitha fushat e jetës. Sepse duhet edhe talenti. Po aq i madh, sa ai i autorit të veprave, që përkthehen. Kongjenial!

Së fundi, duhet kujtue se Komedia asht përkthye me dheta (anglisht frëngjisht, spanjisht...) e deri me qinda herë (160 herë në gjermanisht) në gjuhë të ndryshme të botës. Në përpjekjen për t'iu afrue sa ma shumë origjinalit, që ka arritë një përkryemje gati të paarritshme nga përkthimi. Ndonëse kjo nuk asht e pamundur. Na e kujtojnë, për shembull, "Rubairat e Omar Khajamit", shqipëruem nga penda gjeniale e Nolit. Për të mos harrue përkthyes të tjerë të mëdhaj: Lasgushin, Dhimitër Pasikon, Ernest Koliqin, Don Lazër Shantojën, Henrik Lacen, Petro Zhejin e, ndër ma të mëdhajtë e edhe ma të harruemit, Frano Alkajn.

S'na mbetë tjetër, pra, veç të urojmë t'i shikojmë të përkthye me shumë e shumë herë kryeveprat e letërsisë botnore në gjuhën shqipe. Derisa ndokush të thotë: "Po kjo asht si - e ndoshta - edhe ma e bukur se origjinali".

TRINGË DUKAGJINI, gazetare